

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6085
E mërkurë, 12 gusht 2020
çmimi 0.40 €

KFOR-i: Jemi të përkushtuar për sigurinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI | FAQE 4-5

QEVERIA DUHET T'I KETË 61 VOTA TË PARTIVE SHQIPTARE



Kryetari i Këshillit Kombëtar i Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka vlerësuar se në rrethanat aktuale, Qeverisë së Kosovës i duhen 61 vota të partive shqiptare. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka

thënë se me një shumicë të tillë Kosova do të përballej më lehtë me Gjykatën Speciale, pandeminë dhe dialogun me Serbinë. Sipas tij, për këtë çështje i takon të vendosë partisë së kryeministrit Avdullah Hoti.

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës ka shprehur skepticizëm për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë kontekst, Krasniqi ka thënë se në këtë proces nuk pret ndonjë marrëveshje e cila do t'i konvenojë Kosovës

OPINION

SHKOLLAT TË HAPEN MË 1 SHTATOR | F. 11

Shkruan:
Ferat SHALA



AKTUALE

VJOSA OSMANI: NË POLITIKË DO TË JEM GJATË | F. 3

HOTI KËRKON MOBILIZIM TË PËRGJITHSHËM PËR FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLOR | F. 6

SHOQËRIA CIVILE KËRKON PËRSËRITJEN E PROCESIT PËRZGJEDHËS PËR AVOKAT TË POPULLIT | F. 6

EKONOMI



KOMISIONI EVROPIAN NDAN 100 MILIONË EURO PËR KOSOVËN | F. 8

TAHIRI, PAS VIZITËS NË TRUST: PAS TRI JAVE MUND TË NISIN APLIKIMET PËR TËRHEQJEN E 10-PËRQINDËSHIT | F. 9

SHTYHET AFATI PËR TË APLIKUAR PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE | F. 9

BIK-u: KOMUNIKATA E GJYKATËS SPECIALE PËR THAÇIN DHE VESELIN, VEPRIM POLITIK



Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), e cila drejtohet nga myftiu Naim Tërnavë, e ka vlerësuar politike propozim-maktakuzën kundër presidentit Hashim Thaçi dhe liderit të PDK-së, Kadri Veseli, nga Gjykata Speciale. BIK-u ka theksuar se një

veprim i tillë ka dëmtuar reputacionin e Speciales. Sipas BIK-ut, sulmi ndaj vlerave të UÇK-së po bëhet në emër të drejtësisë me veprime të padrejta dhe në kundërshtim me parimet dhe praktikën e drejtësisë ndërkombëtare | FAQE 2

S'DO TË LEJOHET MONOPOL NGA LABORATORËT PRIVATË PËR TESTE | FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta: Shqiptarët nuk do ta harrojnë kurrë solidaritetin vëllazëror të Italisë

TIRANË, 11 GUSHT (ER) - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka pritur në takim ekipin e mjekëve dhe të infermierëve të ardhur nga Italia për t'i trajnuar strukturat shqiptare shëndetësore me

qëllim arritjen e rezultateve më efektive në luftën me pandeminë e rrezikshme Covid-19.

Meta ka thënë se në takim me mjekët italianë ka theksuar se shkëmbimi i përvojave dhe thellimi i mëte-

jshëm i bashkëpunimit dypalësh kundër kësaj sfide të përbashkët është i domosdoshëm. "Falënderim dhe mirënjohje të thellë për ndihmën tepër të vlefshme dhe bujare të ofruar në këto

çaste të vështira. Shqiptarët nuk do t'i harrojnë kurrë sakrificat dhe këtë solidaritet vëllazëror të Italisë që e forcon edhe më shumë marrëdhënien e shkëlqyer midis dy vendeve e popujve tanë!", ka thënë Meta.



Nacionalizmi në rritje gjatë negociatave për qeverinë e re të Maqedonisë së Veriut

SHKUP, 11 GUSHT - Gjatë kohës që po zhvillohen bisedimet në përpjekje të formimit të qeverisë së re të Maqedonisë së Veriut, në rrjetet sociale nga qarqe të caktuara janë shfaqur qëndrime nacionaliste. Njohësit e çështjeve politike kanë thënë se kjo dukuri nxitet nga vetë partitë politike për të siguruar pozicione më të mira gjatë procesit të negociatave për formimin e qeverisë së re e që duket se është një proces i vështirë pasi rezultati zgjedhor mundëson më shumë kombinime rreth përbërjes së koalicionit të ardhshëm qeveritar.

Përmes një porosie të shpërndarë në rrjetet sociale nga, siç është thënë, ish-ushtarë të UÇK-së, është theksuar se, nëse subjektet maqedonase shkulin vullnetin politik të

shqiptarëve, në atë rast kanë potencuar se janë të gatshëm për luftë. Ndërsa kryetari i partisë majtiste "Levica", i cili është zgjedhur deputet në përbërjen e re parlamentare, duke iu referuar zhvillimeve në Karpallëk të Tetovës, ku humbën jetën 10 pjesëtarë të forcave të sigurisë maqedonase gjatë konfliktit të vitit 2001, në profilin e vet në "Facebook" i është drejtuar me fjalë të rënda ministres së Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska.

Në anën tjetër, Arsim Sinani, njohës i çështjeve politike, për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se partitë politike në Maqedoninë e Veriut, qofshin nga kompleksi politik maqedonas apo ai shqiptar gjithmonë, kur nuk arrijnë t'i realizojnë premtimet gjatë fushatës zgjedhore, këtë e



kamuflojnë përmes nacionalizmave të rrejshëm. "Shoqërisë në Maqedoninë e

Veriut i duhet një nacionalizëm institucional si nga blloku shqiptar, po ashtu dhe ai

maqedonas, që për mua në përkthim do të thotë vendosja e njerëzve të ditur, të duhur, në pozita të caktuara të cilët do të dinë t'i menaxhojnë problemet që i kemi. Është ky një nacionalizëm letargjik që na paraqitet, një lojë ping-pongu për të blerë kohë për t'i matur forcat partitë politike gjatë zhvillimit të bisedimeve për formimin e qeverisë së re të vendit", ka thënë Sinani.

Kurse Vlado Dimovski nga Qendra për Tolerancë Ndëretnike ka vlerësuar se shfaqja e nacionalizmit nga taborë të caktuar politikë tashmë është bërë një dukuri shumë e zakonshme gjatë zgjedhjeve dhe periudhës paszgjedhore. Por, Dimovski beson se sapo të formohet qeveria kjo dukuri do të zbehet në masë të theksuar.

PD-ja: Reforma territoriale në Shqipëri ka dështuar

TIRANË, 11 GUSHT (ER) - Demokratët e kanë renditur reformën territoriale si një nga dështimet më të mëdha të qeverisë Rama pasi, sipas tyre, ajo është përdorur për punësimin e militantëve. "Vetëm në dy vjet, 2017-2019, janë paguar nga taksat e qytetarëve rreth 92 milionë euro për më shumë se 8100 punonjës shtesë me kontratë të përhershme, veçanërisht në pushtetin lokal. Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, çdo i punësuar i ri kushton rreth 580 mijë lekë në muaj. Një nga

arsyet madhore të reformës territoriale ishte reduktimi drastik i shpenzimeve, por punësimi i militantëve në administratën lokale ka sjellë rritjen me 92 milionë euro në 2 vjet të kostos së rrogave të tyre", është thënë në reagimin e Partisë Demokratike (PD).

Ekspertët e Partisë Demokratike kanë vlerësuar se në raport me dy vjet më parë ka 3 për qind më pak teknikë dhe specialistë në bashkitë e vendit, ndërsa është rritur 15 për qind numri i nëpunësve të lartë dhe drejtuesve. "Këta janë njerëzit

që ngrohin karriget e zyrave, nuk bëjnë asnjë punë dhe sjellin njerëzit vërdallë. Ne harxhojmë 46 milionë euro në vit për pagat e tyre që këta parazitë të pushtetit të bëjnë 'like' dhe share në 'Facebook'-un e Edi Ramës dhe të keqpërdoren në fushatë elektorale", është thënë në këtë reagim.

Reforma administrative territoriale, sipas Partisë Demokratike, ka dështuar pasi ka prodhuar më shumë korrupsion e më pak shërbime për qytetarët.



Pesë të vdekur nga koronavirusi dhe 140 raste të reja në Shqipëri



TIRANË, 11 GUSHT (ER) - Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë regjistruar 140 raste të reja me koronavirus, ndërsa

janë shëruar 101 pacientë. Gjatë këtyre 24 orëve kanë humbur jetën pesë pacientë, ku dy prej tyre nuk kanë pasur sëmundje shoqëruese. Aktualisht në

Spitalin Infektiv po trajtohen 124 pacientë të konfirmuar pozitivë me Covid-19, ndërsa 18 prej tyre janë në terapi intensive, katër prej të cilëve janë në

intubim. Deri më tani në Shqipëri janë kryer 47 mijë teste. 6 676 persona kanë rezultuar pozitivë, ndërsa raste aktive janë 2 991.

BIK-u: Komunikata e Gjykatës Speciale për Thaçin e Veselin, veprim politik

Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), e cila drejtohet nga myftiu Naim Tërnavë, e ka vlerësuar politike propozimaktakuzën kundër presidentit Hashim Thaçi dhe liderit të PDK-së, Kadri Veseli, nga Gjykata Speciale. BIK-u ka theksuar se një veprim i tillë ka dëmton reputacionin e Speciales. Sipas BIK-ut, sulmi ndaj vlerave të UÇK-së po bëhet në emër të drejtësisë me veprime të padrejta dhe në kundërshtim me parimet dhe praktikën e drejtësisë ndërkombëtare

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU


PRISHTINË, 11 GUSHT - Bashkësia Islame e Kosovës e ka vlerësuar politike komunikatën e Gjykatës Speciale, përmes së cilës është bërë publike propozimaktakuza për krime lufte ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe liderit të PDK-së, Kadri Veseli. Përmes një deklarate, BIK-u ka theksuar ky

veprim politik dëmton vetë kredibilitetin dhe besueshmërinë e Gjykatës Speciale. "Me shqetësim të thellë kemi ndjekur veprimet e drejtësisë ndërkombëtare ndaj presidentit të vendit, z. Hashim Thaçi dhe udhëheqësve të tjerë të UÇK-së. Komunikatën e prokurorëve ndërkombëtarë për presidentin Thaçi, duke u bazuar në momentin e bërjes së saj publike, e konsiderojmë

veprim politik që dëmton së pari kredibilitetin dhe besueshmërinë e gjykatës dhe, së dyti, konsiderojmë se, në emër të drejtësisë, po mëtohet të atakohen e përdhosen kauza dhe misioni i UÇK-së për lirinë e vendit", është thënë në deklaratën e BIK-ut. Sipas BIK-ut, sulmi ndaj vlerave të UÇK-së po bëhet në emër të drejtësisë me veprime të padrejta dhe në

kundërshtim me parimet dhe praktikën e drejtësisë ndërkombëtare. "Tentimi për ta paraqitur kriminale luftën e drejtë të UÇK-së është tentim për ta barazuar kriminelin me viktimën. Ne i bashkohemi fuqishëm zërit të popullit që kërkon drejtësi për viktimat e luftës në Kosovë, duke e vlerësuar të paprecedent qasjen e drejtësisë ndërkombëtare, që kohë më parë publikuan edhe një njoftim për një aktakuzë të pakonfirmuar ndaj dy prej liderëve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaçit dhe z. Kadri Veselit", është thënë në deklaratë. BIK-u ka vlerësuar se ky veprim përbën shkelje të drejtave të

njeriut si dhe shkel parimin bazë të drejtësisë, prezumimin e pafajësisë. "Ne, si edhe tërë populli, UÇK-në e konsiderojmë vlerën më të madhe dhe më të suksesshme në historinë më të re të popullit tonë dhe të cilën e ruajmë me shumë mburrje. Rithekojmë edhe një herë se lufta mbrojtëse e UÇK-së, e cila është bërë në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, ka qenë e drejtë dhe do të mbetet përgjithmonë e tillë. Ne besojmë dhe angazhohemi për drejtësi, por konsiderojmë se me veprime të padrejta, selektive e të njëanshme nuk mund të vendoset drejtësia", ka përfunduar deklarata për media e BIK-ut.



Vjosa Osmani: Në politikë do të jem gjatë

MITROVICË, 11 GUSHT (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se në skenën politike do të jetë për një kohë të gjatë. Gjatë një bashkëbisedimi me të rinjtë e Mitrovicës, ajo ka deklaruar se do të jetë aty ku e duan qytetarët e Kosovës. "Do të më shihni edhe shumë gjatë në skenën politike të Kosovës dhe do të më shihni me njerëzit që ia duan të mirën Kosovës dhe tash po shihet se kush ia do të mirën Kosovës. Unë do të jem aty ku më duan qytetarët. Në qoftë se dikujt i shkon mendja ta bëjë pjesë të negociatave, qoftë duke i dhënë territor apo duke e shndërruar



Mitrovicën në një vend tilla nuk do të lejohen", është jofunksional, atëherë plane të shprehur Osmani, kur është

pyetur nga një qytetar për të ardhmen politike. Gjatë këtij bashkëbisedimi Osmani ka folur edhe për çështjen e ambientit, për të cilën temë ka thënë se duhet të flitet më shumë se një herë në vit. "Në emër të Kuvendit të solidarizohemi me qytetarët e Mitrovicës për këtë pandemi të tmerrshme, por duhet të siguroheni që kurdo që vjen koha rindërtimi i ekonomisë sonë të bëhet duke ndërtuar një ambient për të gjithë. Investimi kryesor do të duhet të jetë në arsim dhe ambient. Ne duhet ta detyrojmë qeverinë me ligj që të mbjellë drunjt në komuna", ka thënë Osmani.

Ndërsa kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se në këtë komunë tani për tani janë duke u pastruar dy lumenj. Në anën tjetër, kryetarja e Komisionit për Shëndetësi, Albena Reshitaj, ka thënë se në Mitrovicë gjithmonë ka pasur probleme në zhvillimet politike dhe ekonomike. "Ne e dimë se Mitrovica në zhvillimet politike dhe ekonomike ka pasur gjithmonë probleme. Mendoj se nëse flasim për mjedisin, ne po luftojmë për ta mbrojtur shëndetin tonë dhe më vjen mirë që në kohën si ministre kam sjellë projekte për mjedisin", ka thënë Reshitaj.

Flet për “Epokën e re”, Jakup Krasniqi

Qeveria duhet t’i ketë 61 vota të



Kryetari i Këshillit Kombëtar i Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka vlerësuar se në rrethanat aktuale, Qeverisë së Kosovës i duhen 61 vota të partive shqiptare. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se me një shumicë të tillë Kosova do të përballej më lehtë me Gjykatën Speciale, pandeminë dhe dialogun me Serbinë. Sipas tij, për këtë çështje i takon të vendosë partisë së kryeministrit Avdullah Hoti. Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës ka shprehur skepticizëm për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë kontekst, Krasniqi ka thënë se në këtë proces nuk pret ndonjë marrëveshje e cila do t’i konvenojë Kosovës

marrëveshje që i konvenon Kosovës. “Procesi i dialogut ka filluar keq që në nismën e tij. Kjo qeveri e ka tepër vështirë ta vendosë në binarë të kënaqshëm. Por, Kosova nuk duhet ta marrë përgjegjësinë e mosgatishmërisë për dialog. Personalisht as kam pritur e as pres ndonjë marrëveshje që i konvenon Kosovës”, është shprehur ai.

Krasniqi ka folur edhe për mocionin e mosbesimit të iniciuar nga Lëvizja Vetëvendosje. Sipas tij, para se të bëhej mocioni, kërkuesi i tij duhet të mendojë a i ka numrat për arritjen e qëllimit.

“Nëse opozita nuk i ka numrat dhe e bën mocionin e mosbesimit, ia bën një shërbim të mirë qeverisë Hoti. Pra, mocioni është e drejtë ligjore e kushtetuese e opozitës. Por, mocioni i opozitës mund të jetë edhe një legjitimitet shtesë i Qeverisë aktuale?! Prandaj duhet ta mendojë se a mund të kenë

sukses”, ka thënë Krasniqi. Sa i përket punës së qeverisë, Krasniqi ka thënë se me problemet e brendshme që i ka partia që drejton qeverinë, është vështirë të ketë qeverisje të suksesshme. “Për t’u vlerësuar puna e një qeverie duhet të kalojë një periudhë nga 100 ditë pune deri në 6 muaj qeverisje. Po nga ajo që po shihet, ky kabinet qeveritar ka probleme brendapërbrenda partisë që e ka qeverinë. Me këto probleme të brendshme është vështirë të ketë qeverisje të suksesshme”, ka deklaruar Krasniqi.

“Epoka e re”: Z. Krasniqi, cili është vlerësimi juaj për punën e deritashme të qeverisë Hoti?

Krasniqi: Për t’u vlerësuar puna e një qeverie duhet të kalojë një periudhë nga 100 ditë pune deri në 6 muaj qeverisje. Po nga ajo që po shihet, ky kabinet qeveritar ka probleme brendapërbrenda partisë që e ka qeverinë. Me

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 GUSHT - Kryetari i Këshillit Kombëtar i Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka bërë me dije se në këtë situatë kur Kosova po përballlet me sfida të shumta, qeverisë së vendit i duhen 61 vota të partive shqiptare. Ai ka vlerësuar se me një shumicë të tillë Kosova do të përballej më lehtë me Gjykatën Speciale,

pandeminë dhe dialogun me Serbinë.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Krasniqi ka thënë se për këtë çështje duhet të vendosë partia nga e cila vjen kryeministri Avdullah Hoti, LDK-ja. “Ajo që mendoj se i duhet Qeverisë së Kosovës në një situatë të tillë, është se qeveria duhet t’i ketë 61 vota të partive shqiptare. Por, për këtë duhet të vendosë partia që e ka kryeministrin. Në një situatë të

tillë, Kosova do të përballej më lehtë me Gjykatën Speciale, pandeminë dhe dialogun me Serbinë”, ka thënë Krasniqi.

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës ka shprehur skepticizëm për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Sipas tij, ky proces ka filluar keq që në nisje dhe kjo qeveri e ka vështirë ta kthejë në binarë e duhur. Krasniqi ka treguar se në këtë proces as nuk ka pritur e as nuk pret ndonjë

ë partive shqiptare

këto probleme të brendshme është vështirë të ketë qeverisje të suksesshme.

“Epoka e re”: Partia më e madhe opozitare, Lëvizja Vetëvendosje, ka nisur procedurat për një mocion mosbesimi ndaj qeverisë. Mund ta rrezikojë ky mocion qeverinë aktuale?

Krasniqi: Kam thënë në një rast tjetër se është e drejtë legjitime e opozitës të kërkojë mocion mosbesimi për qeverinë Hoti, por para se të bëhej mocioni, kërkuesi i tij duhet të mendojë a i ka numrat për arritjen e qëllimit. Nëse opozita nuk i ka numrat dhe e bën mocionin e mosbesimit, ia bën një shërbim të mirë qeverisë Hoti. Pra, mocioni është e drejtë ligjore e kushtetuese e opozitës. Por, mocioni i opozitës mund të jetë edhe një legjitimitet shtesë i qeverisë aktuale?! Prandaj duhet ta mendojë se a mund të kenë sukses.

“Epoka e re”: Kosova tashmë ka rifilluar procesin e dialogut me Serbinë në Bruksel. Si e keni parë fillimin e këtij procesi?

Krasniqi: Procesi i dialogut ka filluar keq që në nismën e tij. Kjo qeveri e ka tepër vështirë që ta vendosë në binarë të kënaqshëm. Por, Kosova nuk duhet ta marrë përgjegjësinë e mosgatishmërisë për dialog. Personalisht as kam pritur e as

pres ndonjë marrëveshje që i konvenon Kosovës.

“Epoka e re”: Siç po shihet, as kjo qeveri nuk po mund ta unifikojë spektrin politik rreth dialogut me Serbinë. Si duhet të veprojnë institucionet dhe partitë politike në këto rrethana?

Krasniqi: Përgjegjësia e unifikimit kombëtar në raport me Serbinë nuk i përket një partie politike. Fryma politike, kultura e gjuha e komunikimit nuk është shpresëdhënëse se mund të krijojmë unitet.

“Epoka e re”: Duke parë sfidat me të cilat po përballlet Kosova, pandeminë, Gjykatën Speciale, dialogun me Serbinë, sa mund ta vazhdojë mandatin kjo qeveri, apo pritni zgjerim të koalicionit qeverisës?

Krasniqi: Ajo që mendoj se i duhet Qeverisë së Kosovës në një situatë të tillë, është se qeveria duhet t’i ketë 61 vota të partive shqiptare. Por, për këtë duhet të vendosë partia që e ka kryeministrin. Në një situatë të tillë Kosova do të përballëj më lehtë me Gjykatën Speciale, pandeminë dhe dialogun me Serbinë. Natyrisht, niveli intelektual, politik e qeverisës i njerëzve në institucionet e Kosovës është i mbushur me xhambazë politikë e jo me intelektualë të përgjegjshëm që kanë dije e përgjegjësi politike për të qeverisur! Ky është problem i madh shoqëror në Kosovë.

Kërkohe koordinim me KFOR-in për fushën e sigurisë në Kosovë

PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka mbajtur të martën një takim virtual me drejtuesit e institucioneve të sigurisë së vendit, me të cilët ka biseduar për gjendjen e përgjithshme në vend dhe për bashkërendimin e veprimeve institucionale në fushë të sigurisë. Pjesëmarrës të këtij takimi ishin ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, drejtori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Kreshnik Gashi, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletnënt Rrahman

Rama, dhe drejtori i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj. Në këtë bashkëbisedim kryeministri Hoti i ka falënderuar përfaqësuesit e institucioneve të sigurisë në vend për përkushtimin dhe angazhimin e shtuar të tyre për përballimin e gjendjes së krijuar si pasojë e pandemisë Covid-19. Po ashtu, ai ka kërkuar që ky përkushtim dhe ky mobilizim i këtyre institucioneve të vazhdojë edhe më tutje, ndërkohë ka kërkuar edhe koordinim me mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë, në veçanti me KFOR-in si një partner strategjik i Kosovës në fushë të mbrojtjes dhe sigurisë.



KFOR-i: Jemi të përkushtuar për sigurinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës

PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Komandanti i KFOR-it, i udhëhequr nga NATO-ja, komanda rajonale lindje, koloneli Eric Riley, është takuar të martën me kryetarin e Kamenicës, Qëndron Kastrati. Takimi ishte pjesë e kontakteve të rregullta të mbajtura ndërmjet personelit të KFOR-it dhe autoriteteve lokale në Kosovë.

Riley dhe Kastrati kanë shkëmbyer mendime për një sërë çështjesh me interes të ndërsjellë, përfshirë sigurinë në zonë. Ai ka ripohuar angazhimin e KFOR-it për ta vazhduar forcimin e përpjekjeve të veta të qëndrueshme dhe të paanshme për të ndihmuar në sigurimin që situata lokale të jetë në dobi të të gjithë qytetarëve që jetojnë në komunë. “Trupat e KFOR-it do



ta vazhdojnë patrullimin e tyre të rregullt në të gjithë zonën, në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe organizatat tjera të sigurisë”, ka thënë ai. Në këtë takim është diskutuar edhe për ndikimin e pandemisë Covid-19 në komunitetet e Kamenicës, derisa KFOR-i është duke mbështetur institucionet në

Kosovë në të gjitha nivelet për t’iu përgjigjur kësaj emergjence. Komandanti i Forcave Ndërkombëtare Paqeruajtëse, gjeneralmajor Michele Risi, i cili ka qenë në kontakte të rregullta me zyrtarë të ndryshëm nga institucione të ndryshme në Kosovë, ka ripohuar angazhimin e misionit të udhëhequr nga NATO për të

vazhduar të kontribuojë në një mënyrë të paanshme në një mjedis të qetë dhe të sigurt dhe liri të lëvizjes për të gjithë qytetarët në Kosovë, siç përcaktohet me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. “Që nga viti 1999, në kryerjen e misionit të vet, KFOR-i ka mbështetur zhvillimin e një Kosove të qëndrueshme dhe paqësore dhe do të vazhdojë ta forcojë partneritetin e gjatë që ekziston me institucionet vendore dhe organizatat e sigurisë dhe Komunitetin Ndërkombëtar”, ka theksuar Risi. Më tutje, ai ka thënë se KFOR-i ka mbështetur reagimin vendor ndaj krizës me Covid-19, duke lehtësuar dërgimin e ndihmës thelbësore nga aleatët dhe partnerët e NATO-s si dhe dhurimin e pajisjeve të

mbrojtjes personale në disa komuna dhe komunitete lokale, qendra shëndetësore dhe njësisë të Policisë së Kosovës. Ai ka theksuar se bashkëpunimi në mes të Policisë së Kosovës dhe misionit të NATO-s në Kosovë ka qenë shumë efektiv. “Bashkëpunimi midis KFOR-it dhe Policisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera të sigurisë është shumë efektiv dhe po rritet çdo ditë përmes mekanizmave të konsoliduar të koordinimit të përbashkët në nivele të ndryshme operative. Qëllimi është forcimi i mëtutjeshëm i mbrojtjes, sigurisë dhe lirisë së lëvizjes së të gjitha komuniteteve në Kosovë që KFOR-i dëshiron të sigurojë, në të mirë të sigurisë vendore dhe stabilitetit rajonal”, është shprehur komandanti i KFOR-it.

Shoqëria civile kërkon përsëritjen e procesit përzgjedhës për Avokat të Popullit

PRISHTINË, 11 GUSHT - Rrjeti i Grave të Kosovës, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Instituti KIPRED përmes një komunikate për media kanë kërkuar ripërsëritjen e procesit përzgjedhës për Avokat të Popullit në përputhje me Memorandumin e nënshkruar ndërmjet Kuvendit dhe Ambasadës Britanike. Shoqëria civile, e cila ka monitoruar në mënyrë direkte këtë proces, ka vlerësuar se ka pasur probleme serioze në kuptim të transparencës. “Ne, organizatat e poshtëshënuara, përsërisim qëndrimin tonë kundërshtues ndaj procesit përzgjedhës për Avokat të Popullit të organizuar nga Paneli Vlerësues i themeluar nga Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut. Duke qenë se disa nga ne e kemi monitoruar

në mënyrë direkte një proces të tillë, kemi vërejtur probleme serioze në kuptim të transparencës, respektit për parimin e meritës dhe ligjshmërisë së zbatimit të kriterëve përzgjedhës” është thënë në këtë komunikatën e këtyre organizatave. Ndërsa Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione të martën ka dështuar ta dërgojë listën e ngushtë të kandidatëve për Avokat të Popullit në seancë për votim pasi nuk pasur kuorum në kohën e votimit për shkak të largimit të dy anëtarëve të komisionit nga radhët e LV-së. Arsye për larim të tyre është bërë kandidati Enver Hasani, i cili, sipas pikëve, rezultoi të jetë i katërti me radhë. E për shkak se kandidatja Edona Hajrullahu, e para dhe Naim Qelaj, i dyti,



janë me pikë të njëjta, është kërkuar që në seancë të dërgohen katër kandidatë dhe jo tre siç parashihet. Kandidati i

tretë, sipas pikëve, është Xhavit Shala. Deputeti i LV-së, Salih Zyba dhe ajo e AAK-së, Teuta Haxhiu, nuk kanë pranuar të

votojnë pa një interpretim ligjor se pse nuk po dërgohen tre anëtarë siç parashihet ligji, por katër.

Hoti kërkon mobilizim të përgjithshëm për fillimin e vitit të ri shkollor

PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Me kërkesë të kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, Asociacioni i Komunave të Kosovës ka organizuar të martën një takim virtual me kryetarët e komunave dhe me drejtorët e Departamenteve Komunale të Arsimit (DKA), në të cilin është diskutuar për përgatitjet finale që po i bëjnë institucionet e vendit për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021. Në këtë bashkëbisedim kanë marrë pjesë edhe ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, dhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ndërsa Instituti Kombëtar i Shëndetësisë



Publike është përfaqësuar nga Merita Koçinaj - Berisha, e cila është edhe prorektore e Universitetit të Prishtinës. Me këtë rast, Hoti ka kërkuar nga të

gjitha institucionet relevante të arsimit në vend që t'i bëjnë përgatitjet e nevojshme për ta filluar sa më mbarë vitin e ri akademik, gjithnjë duke i

marrë parasysh rekomandimet e ekspertëve të shëndetësisë për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19.

Ndërsa ministri i Arsimit dhe Shkencës (MASH), Ramë Likaj, ka theksuar se kjo ministri është në fazën përfundimtare të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021. Likaj gjatë këtij bashkëbisedimi ka paraqitur tre skenarë të kësaj ministrie për fillimin e vitit të ri shkollor, të cilët janë: skenari “A”, rikthimi në ambientet shkollorë, ai “B”, mësimi i kombinuar, dhe skenari “C”, mësimi nga platformat e ndryshme. Në këtë takim, pjesëmarrësit janë pajtuar që

opsionet e MASH-it të shndërrohen sa më parë në vendime dhe si të tilla t'u dërgohen Departamenteve Komunale të Arsimit (DK), të cilat, varësisht nga kapacitet që kanë, duhet të përcaktohen se cilin opsion do ta zbatojnë në komunën e tyre. “Sidoqoftë, mbizotëroi qëndrimi se, sidomos për klasat e ulëta, prioritet t'i jepet mundësisë së pjesëmarrjes fizike të nxënësve në procesin mësimor, nëse këtë e mundësojnë kushtet epidemiologjike. Kryeministri Hoti kërkoi bashkërendim veprimesh institucionale në fushë të sigurisë”, ka njoftuar Zyra e Kryeministrit.

Nagavci kërkon të votohet mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë Hoti



PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ditë më parë ka kërkuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nënshkrimet për mocionin e mosbesimit për rrëzimin e qeverisë Hoti. Deputetja e Vetëvendosjes dhe nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci, u ka bërë thirrje partive që bëjnë kritika për keqqeverisje dhe keqmenaxhim të qeverisë Hoti ta nënshkruajnë mocionin dhe ta votojnë atë e jo të bëjnë deklarata e paraqitje joserioze nëpër studio televizive.

“Nagavci ka thënë se Kosovës i duhen institucione të legjitimuara. Nëse nuk e bëjnë këtë, atëherë të paktën le të na kursejnë nga deklaratat e paraqitjet joserioze e të pasinqerta në Kuvend, konferenca e studio televizive. Qytetarët, bizneset, institucionet kanë brena e po përballen me shumë sfida. Koha është për veprime konkrete e të shpejta, jo për deklarata të paqëndrueshme e kalkulime partiake”, ka shkruar Nagavci në llogarinë e vet në “Facebook”.

MSh-ja dhe AKK-ja zotohen të mos lejojnë marrëveshje për çmimet e testeve të Covid-19

S'do të lejohet monopol nga laboratorët privatë për teste

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, dhe kryetari i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Valon Prestreshi, janë zotuar se nuk do të lejohet monopol nga laboratorët privatë që janë licencuar për teste Covid-19. Ata kanë deklaruar se institucionet private shëndetësore do të monitorohen nga autoritetet shtetërore



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 11 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë (MSh), Armend Zemaj, dhe kryetari i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Valon Prestreshi, kanë bërë me dije se institucionet private që janë të licencuara për testim për Covid-19 do të monitorohen dhe nuk do të lejohet ndonjë marrëveshje e çmimeve që do t'i dëmtojë qytetarët. Në një konferencë për media, Zemaj ka thënë se ka rënë dakord që ky proces të zhvillohet duke respektuar politikën e konkurrencës dhe duke mos lejuar monopol. "U pajtuam të koordinohemi ngushtë që procesi të zhvillohet duke respektuar politikën e konkurrencës e të mos lejohet monopol. Të gjitha institucionet e licencuara dhe ato që do të licencohen u bëhet me dije që ky proces do të monitorohet nga të gjitha autoritetet shtetërore vendimmarrëse. Ne e kemi dërguar kompetencën tek institucionet e brendshme, tek inspektorati dhe IKShPK-ja. Si ministër i Shëndetësisë i kam kërkuar AKK-së që ta monitorojë sjelljen lidhur me caktimin e çmimit të këtij shërbimi", ka thënë Zemaj. Kurse kryetari i AKK-së, Valon Prestreshi, ka garantuar se ky autoritet do ta mbështesë këtë proces dhe nuk do të lejojë asnjë marrëveshje rreth çmimit të shërbimit të testimit në mes të laboratorëve të licencuar nga

Ministria e Shëndetësisë. "Në takimin lidhur me licencimin e laboratorëve unë i ofrova ministrit Zemaj se AKK-ja do të jetë në gatishmëri të plotë për të mbikëqyrë këtë proces. E dini që nga ditët e para kur ka filluar pandemia, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë të gjitha masat për t'i parandaluar shkeljet e mundshme të konkurrencës. Gjatë muajit prill ka pasur dyshime për shkelje të konkurrencës në rastet e shitjes së dezinfektuesve dhe alkoolit. E sapo të kemi diçka të re do t'ju informojmë", ka deklaruar Prestreshi, duke u bërë thirrje institucioneve të licencuara që në mënyrë të pavarur ta bëjnë caktimin e çmimeve të shërbimeve.

Ministria e Shëndetësisë të hënën ka licencuar 29 institucione private për testim për Covid-19.

13 të vdekur, 190 të shëruar dhe 171 raste të reja me Covid-19

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të martën se në 24 orët e fundit në vendin tonë kanë ndërruar jetë 13 persona si pasojë e Covid-19 si dhe janë paraqitur 171 raste të reja. Në njoftimin për media instituti ka treguar se janë shëruar nga Covid-19 edhe 190 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR,

janë testuar gjithsej 463 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 171 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 13 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 10 590 raste nga 41 615 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 354 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 190 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 6 248 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 988", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Komuna e Prishtinës vazhdon ta ketë numrin më të mardh të të infektuarve brenda 24 orëve me 46 raste, pastaj vijjnë: komuna e Gjilanit me 24 raste, komuna e Gjakovës 15 raste, komuna e Vitisë 13 raste, komuna e Fushës Kosovës 9 raste, komuna e Pejës 7 raste, komuna e Drenasit 6 raste, komuna e Prizrenit 6

Pezullohet protesta e punëtorëve shëndetësorë

Federata e Sindikatave e Shëndetësisë e Kosovës (FSSHK) ka pezulluar protestën që ishte paraparë të mbahej sot (e mërkurë). Pezullimi i protestës ka ardhur pasi përfaqësuesit e kësaj sindikate janë takuar me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj. "Zemaj u zotua se kërkesat e FSSHK-së do të realizohen dhe për këtë ka marrë edhe mbështetjen e kryeministrit, si dhe pas vendimit për ndalimin e protestës nga ana e organeve të rendit, Këshilli Organizativ i

Protestës, duke i respektuar zotimet e ministrit, institucioneve shtetërore të MPB-së si dhe shëndetin e popullatës merr vendim që ta pezullojë protestën e paraparë më datë 12.08.2020 dhe t'i hapë rrugë dialogut social", është thënë në njoftimin e FSSHK-së.

Federata e Sindikatave e Shëndetësisë e Kosovës ka kërkuar rritje të pagave për punëtorët shëndetësorë dhe jo shtesa siç ka parashikuar Qeveria e Kosovës.

raste, komuna e Suharekës 6 raste, komuna e Ferizajt 5 raste, komuna e Klinës 5 raste, komuna e Lipjanit 5 raste, komuna e Dragashit 4 raste, komuna e Istogut 3 raste, komuna e Kamenicës 3 raste,

komuna e Malishevës 3 raste, komuna e Obiliqit 3 raste, komuna e Podujevës 3 raste, komuna e Vushtrrisë 2 raste dhe me nga një rast komunat e Mitrovicës, Rahovecit dhe Shtimes.

Mbi 600 pacientë të shtrirë në spitalet publike në Kosovë

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të martën se në institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht janë të shtrirë 628 pacientë, prej tyre 440 janë të prekur me koronavirus. Në raportin ditor të ShSKUK-së është thënë se 14 pacientë janë në

respiratorë, 27 janë duke u trajtuar me makinat e frymëmarrjes, CPAP, derisa 419 të tjerë janë në oksigjenoterapi. Kosova ka gjithsej 700 shtretër në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale. Këtij vendi të martën i janë shtuar 171 raste të reja me koronavirus, pas marrjes së 463 mostrave.

Ramadani: Testet e ardhura nga Serbia nuk i përdorëm

Kryetari i Institutit i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK), Naser Ramadani, ka raportuar para komisionit hetimor parlamentar për menaxhimin e Covid-19. I pyetur se çfarë ka ndodhur me 1 000 testet e ardhura nga Serbia, Ramadani ka thënë se ato janë pranuar nga Ministria e Shëndetësisë, por

ende nuk janë përdorur. Në këtë komision, Ramadani ka thënë se më 7 janar kanë bërë kërkesën për furnizim me reagensë, menjëherë pas konfirmimit me rastet e para me Covid-19. "Ekipi mjekësor ka ekzistuar në aeroport, por më pas ne kemi dërguar edhe ekipe plotësuese", ka thënë Ramadani.



ASK-ja: Çmimet e qumështit, vezëve, pemëve dhe perimeve pësuan rënie

Inflacioni mujor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) ishte -0.3 për qind në muajin korrik 2020 krahasuar me muajin qershor të këtij viti. Kjo është bërë me dije nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), duke bërë me dije se janë rritur çmimet e qumështit, vezëve, pemëve dhe perimeve



e COICOP-it: perime (-4.5 për qind); pije alkoolike (-2.0 për qind); përdorim i pajisjeve për transportin personal (-15.6 për qind) - (rënie e çmimeve të naftës dhe benzinës), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-1.4 për qind) në IHÇK", është thënë në raportin e ASK-së, duke u shtuar se ngritje e çmimeve vërehet te nëngrupet e

COICOP-it: bukë dhe drithëra (2.4 për qind); mish (1.1 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (2.1 për qind); pemë (5.6 për qind); sheqer, reçel, mjaltë, çokolatë dhe ëmbëlsira (4.5 për qind); kafe, çaj dhe kakao (5.9 për qind); ujë, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (1.5 për qind); duhan (2.1 për qind); produkte mjekësore, aparaturë dhe

pajisje (5.0 për qind); shërbime ambulatore (5.5 për qind); blerje e automjeteve (0.8 për qind); shërbime hoteliere (2.8 për qind); kujdes personal (1.7 për qind); gjëra personale (3.3 për qind); sigurime (19.7 për qind) - (ngritje e çmimeve të sigurimeve të automjeteve), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 1.3 përqindësh në IHÇK.

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 GUSHT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka bërë me dije se inflacioni mujor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) ishte -0.3 për qind në muajin korrik 2020, krahasuar me muajin qershor 2020. Kjo kryesisht është shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: qumësht, djathë dhe vezë (-1.8 për qind); pemë (-3.8 për qind); perime (-12.1 për qind); pijet alkoolike (-1.8 për qind); energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (-1.2 për qind) - (rënie e çmimeve të drunjve për ngrohje), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.7) përqindësh në IHÇK.

Ndërsa ngritje e çmimeve është vërejtur te nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (0.5 për qind); duhan (1.5 për qind); përdorim i pajisjeve për transportin personal (3.1 për qind) - (ngritje e çmimeve të naftës dhe benzinës), shërbime për transport (5.9 për qind) - (ngritje e çmimeve të biletave të transportit ajror), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.4 për qind në IHÇK. "Norma vjetore e inflacionit, e matur në muajin korrik 2020 me muajin korrik 2019, ishte (-0.1 për qind). Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit pësoi rënie në një mesatare prej (-0.1 për qind) në muajin korrik 2020, krahasuar me muajin korrik 2019. Kjo kryesisht është shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te nëngrupet

Shtyhet afati për të aplikuar për legalizimin e ndërtimeve pa leje

PRISHTINË, 11 GUSHT 2020 - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) ka marrë vendim që afati për dorëzimin e aplikacioneve për legalizimin e ndërtimeve pa leje të vazhdohet për 12 muaj, pra deri më 4 shtator 2021, në mënyrë që qytetarëve t'u mundësohet kohë shtesë për t'i dorëzuar aplikacionet për legalizim. "Duke parë situatën në terren, ky vendim ka ardhur si rezultat i nevojës për kohë shtesë për ta arritur qëllimin e Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, duke përfshirë këtu faktin se komunat vazhdojnë të punojnë me kapacitete të limituara për shkak të pandemisë, si dhe rrethanave të tjera që kjo situatë ka shkaktuar në tërësi. Vendimin e plotë për vazhdimin e afatit për dorëzimin e aplikacioneve për legalizimin e ndërtimeve pa leje i nënshkruar nga ministri i MEA-së, Blerim Kuçi, mund të gjendet në linkun e Gazetës Zyrtare më poshtë dhe të bashkëngjitur në këtë e-mail", ka njoftuar Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA).

Kjo ministri ka theksuar se programi i Qeverisë së Kosovës për trajtimin e ndër-



LEGALIZO NDËRTIMIN

timeve pa leje (programi i legalizimit) është një iniciativë e rëndësishme që pritet të prodhojë përfitime të prekshme për qytetarët e Kosovës, përfshirë këtu përmes sqarimit të të drejtave pronësore nëpërmjet regjistrimit në kadastrë dhe në Regjistrin e të Drejtave në Pronë të Paluajtshme (RDPP), duke e zhbllokuar kapitalin aktualisht të kyçur në ndërtimeve pa leje, që do të mund të përdoret për ta nxitur rritjen ekonomike.

Ekzekutohet edhe pjesa e dytë e 170 eurove për 54 mijë përfitues

PRISHTINË, 11 GUSHT - Ministrja e Financave dhe Transfereve, Hykmete Bajrami, ka bërë me dije se sot deri në orën 13:00 është ekzekutuar edhe pjesa e dytë e listës nga masa 3a e pakos emergjente, për 53 248 përfitues, me shumë totale 9 446 560 euro. Bajrami ka deklaruar se stafi i Ministrisë së Tregtisë është në proces të përgatitjes së listave 3a për bizneset si dhe ekzekutimin e masës 8. Masa 3a e pakos emergjente nënkupton mbështetjen financiare për shoqëritë tregtare që janë në vështirë financiare si

rezultat i situatës emergjente dhe atë: (a) mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej 170 eurosh (për dy muaj). "Ministria e Financave njofton se sot deri në orën 13:00 është ekzekutuar edhe pjesa e dytë e listës nga masa 3a, për 53 248 përfitues me shumë totale 9 446 560 00 euro. Stafi i Ministrisë së Financave është në proces të përgatitjes së listave 3a për bizneset si dhe ekzekutimin e masës 8. Ju falënderojmë për durimin!", ka shkruar Bajrami në profilin e vet në "Facebook".



Komisioni Evropian jep 100 milionë euro për Kosovën

BRUKSEL, 11 GUSHT (ER) - Komisioni Evropian (KE) ka ndarë të martën 100 milionë euro për Kosovën. Kushtet e politikave për këto 100 milionë

euro nga programi mikro-financiar lidhen me forcimin e stabilitetit publik financiar, adresimin e papunësisë së të rinjve, përmirësimin e qeveris-

jes së mirë dhe luftimin kundër korrupsionit. Nga skema e ndihmës mikro-financiare, përveç Kosovës, kanë përfituar edhe Shqipëria 180 milionë,

Gjeorgjia 150 milionë, Jordania 700 milionë, Moldavia 100 milionë, Mali i Zi 60 milionë, Maqedonia e Veriut 160 milionë dhe Ukraina 1.2 miliard euro.



Abrashi: Rehabilitimi i hekurudhave rrit mundësinë për investime

Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka inspektuar punimet e hekurudhës së Kosovës, në linjën 10-të. Ai ka thënë se pret që faza e parë e projektit për rehabilitimin e kësaj hekurudhe të përfundojë në kohë rekorde. Sipas tij, rehabilitimi i hekurudhave të Kosovës do të mundësojë që trenat do të lëvizin më shpejt. Po ashtu, ai ka thënë se rehabilitimi i hekurudhave do t'i rrisë mundësitë për investime



investime për ne", është shprehur Abrashi.

Ai ka paralajmëruar se ministria që ai drejton do të punojë edhe në projekte të tjera në mënyrë që Prishtina të shndërrohet në një qendër ndërlidhëse të rajonit, duke u ofruar më shumë mundësi zhvillimit të bizneseve dhe tërheqjen e investimeve. "Ne do të punojmë edhe në projekte të tjera. Në planin tonë do ta paraqesim edhe rehabilitimin e rrugëve nga Prishtina deri në

Merdat dhe pastaj të lidhemi me rrugë me Nishin. Një qendër multimediale, stacion i trenit, autobusëve në Prishtinë, sepse kur kompletohet ky rrjet i hekurudhave dhe autostradave, mund të synojmë që Prishtina të jetë një qendër ndërlidhëse e regjionit që t'u japë edhe më shumë mundësi bizneseve dhe investimeve", ka deklaruar Abrashi. Ndërsa kryeshefi ekzekutiv i Infracosit, Xhevat Ramosaj, ka shprehur gatishmërinë që ky

projekt të vazhdojë dhe të përfundojë me kohë. "Unë shpreha gatishmërinë tonë, që ne ta vazhdojmë këtë projekt dhe të përfundojë me kohë ashtu siç është paraparë por, eventualisht, për shkak të pandemisë, edhe ndonjë vonesë e vogël mund të ndodhë. Por, sidoqoftë, me insistimin dhe punën tonë të përkushtuar edhe të zotit ministër, kemi arritur që ta bëjmë zgjerimin e punëve", ka thënë Ramosaj.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 11 GUSHT - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, i shoqëruar nga kryeshefi ekzekutiv i Infracosit, Xhevat Ramosaj, ka inspektuar të martën punimet e hekurudhës së Kosovës, në linjën 10-të. Me këtë rast, Abrashi ka thënë se pret që faza e parë e projektit për rehabilitimin e kësaj hekurudhe pritet të përfundojë në kohë rekorde dhe do të mundësojë në hekurudhat e Kosovës dhe trenat do të lëvizin më shpejt. "Rehabilitimi i hekurudhës është nënshkruar që disa muaj si kontratë, por në javët e fundit po shohim shtim të punëve, dinamikë më të

madhe të punëve. Shpresojmë që, përkundër pandemisë, të arrijmë që kjo pjesë e hekurudhës, faza e parë të rehabilitohet në kohë rekorde. Kjo punë do të marrë kohë, por jemi këtu që të përkrahim këtë ndërmarrje në mënyrë që ta modernizojmë linjën hekurudhore, pikë së pari këtë pjesë, pastaj do të vazhdojmë edhe në fazën e dytë deri në Mitrovicë, fazën e tretë deri në kufi me Serbinë. Mbi të gjitha, ky është një avancim i hekurudhave të Kosovës, që nënkupton që trenat tani do të lëvizin më shpejt. Shpejtësia të kalojë mbi 100 km në orë, edhe për mallra edhe për udhëtarë, që nënkupton aktivitet ekonomik më të shtuar për vendin, por edhe më shumë

Tahiri, pas vizitës në Trust: Pas tri jave mund të nisim aplikimet për tërheqjen e 10-përqindëshit

Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Tahiri, ka thënë se Ligji për rimëkëmbje ekonomike, me të cilin është paraparë edhe tërheqja e 10 për qind të kursimeve pensionale, tashmë është në Kuvend. Për të do të diskutohet në komisione, pastaj do të shkojë për miratim në seancë plenare. "Procedura e aplikimit do të jetë e thjeshtë. Do të jepet numri personal dhe i xhirollogarisë, të verifikohet nga BQK-ja dhe paratë e Trustit, 10-përqindëshi, do të jetë në xhirollogari të përfituesit, të atij që aplikon", ka thënë Tahiri



EPOKA
ERE **A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 11 GUSHT - Zëvendëskryeministri i parë i vendit, Besnik Tahiri, pas vizitës që të martën i ka bërë Trustit Pensional të Kosovës, ka bërë me dije se, në bazë të planifikimeve, diku pas tre javësh mund t'i nisim aplikimet për tërheqjen e kursimeve prej 10 përqindësh. Tahiri, pas takimit me drejtorin e Trustit, Ardian Zalli, ka thënë se procedura e aplikimit do të

jetë online dhe e thjeshtë, duke e marrë parasysh situatën me pandeminë. "Procedura e aplikimit do të jetë e thjeshtë. Do të jepet numri personal dhe i xhirollogarisë, të verifikohet nga BQK-ja dhe paratë e Trustit, 10-përqindëshi, do të jetë në xhirollogari të përfituesit, të atij që aplikon", ka thënë Tahiri. Ai ka deklaruar se janë mbi 630 349 persona që janë pjesë e kësaj skeme.

Më tutje, Tahiri ka thënë se Ligji për rimëkëmbje

ekonomike është në Kuvend, i cili do të diskutohet në komisionet parlamentare, pastaj do të shkojë në seancë plenare për miratim. "Nuk mund të jap datë, por unë e shpjegova. Ligji është në komisionin parlamentar dhe deri në fund të javës shkon në lexim të parë. Para për tri jave kjo punë mund të ndodhë. Ideja e marrjes së 10 përqindëshit nga Trusti është

një injeksion për ekonominë e Kosovës", ka deklaruar ai. Sipas tij, nëse kjo punë fillon nga shtatori e tutje, rreth 200 milionë euro hyjnë në qarkullim në tregun e Kosovës.

Ardian Zalli nga Trusti ka deklaruar se e kanë njoftuar zëvendëskryeministrin Tahiri me të gjitha përgatitjet që janë duke u bërë për mundësinë e tërheqjes së 10-përqindëshit.

Sipas tij, kjo do të bëhet online dhe mund të bëhet vetëm pasi ligji të hyjë në fuqi, të nënshkruhet nga presidenti e të shpallet në Gazetën Zyrtare. "Besoj se e kemi thjeshtuar procesin. Kurdo që mund të ndodhë aplikimi të bëhet vetëm online dhe kjo shkon edhe në favor të situatës me pandeminë, në mënyrë që të mos përhapet virusi", ka thënë Zalli.

Fillon rehabilitimi i sheshit 'Adem Jashari' në Skenderaj

SKENDERAJ, 11 GUSHT (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se ka filluar rehabilitimi i sheshit "Adem Jashari" në këtë komunë dhe ndërtimi i trotuarit e ndriçimit publik në qendrat e bashkësisë lokale të Prekazit dhe Qirezit. Këto projekte bashkëfinancohen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe "Demos"-i nga njëra anë dhe Komuna e Skenderajt nga anë tjetër, në kuadër të grantit të performancës, grant ky të cilin kjo komunë e ka fituar si rezultat i qeverisjes së mirë. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur në takim dy zëvendësministret e MAPL-së, Fatbardha Emini dhe Magbule Shkodra, bashkë me të cilat ka vizituar punimet për

realizimin e këtyre dy projekteve. Jashari, në ceremoninë e fillimit të dy projekteve në fjalë, ka falënderuar MAPL-në për mbështetjen e dhënë dhe është shprehur i lumtur që si rezultat i qeverisjes së mirë, këtë vit do të realizohen tri projekte, të cilat kapin vlerën totale prej 265 mijë eurosh, prej të cilave 207 mijë janë shpërbllim nga granti i performancës, kurse 58 mijë janë bashkëfinancim nga Komuna e Skenderajt. Duke folur rreth rehabilitimit të sheshit "Adem Jashari", i cili kap vlerën totale prej 75 mijë eurosh, kryetari Jashari ka theksuar se ky projekt është i mirëseardhur pasi me të do të rehabilitohen disa nga pjesët e dëmtuara të sheshit.



Begaj dhe Dumoshi biseduan për investime në Malishevë



MALISHEVË, 11 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur në takim pune ministren e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Vjola Dumoshi, me të cilën kanë biseduar për disa projekte për Malishevën dhe për propozim-projektet që pritet të nisin të realizohen vitin e ardhshëm. Begaj e Dumoshi janë pajtuar për bashkëpunim të ndërsjellë në hartimin e projekteve dhe propozimeve për investime në Komunën e Malishevës në fushat e kulturës, sportit dhe rinisë. Në këtë takim, ishin të pranishëm edhe nënkryetari i

Malishevës, Hajdin Berisha, drejtori i DKRS-së, Rexhep Mazreku, deputetët e Kuvendit të Kosovës, Fetah Rudi dhe Arbëreshë Krasniqi, zëvendësministria e MKRS-së, Valdete Bajrami, zëvendësministri i Bujqësisë, Enver Hoti dhe zyrtarë të tjerë qeveritarë. Në këtë takim, kryetari Begaj e ka njoftuar ministren Dumoshi për gjendjen në Malishevë, duke thënë se infektimet në sport, kulturë dhe rini janë të domosdoshme. Ndërsa ministrja Dumoshi ka premtuar se të gjitha kërkesat e Komunës së Malishevës do të procedohen për vitin 2021.

Përfundon asfaltimi i rrugës 'Ali Hadri' në Kamenicë

KAMENICË, 11 GUSHT (ER) - Punët në Komunën e Kamenicës janë duke vazhduar edhe në kohën e pandemisë, ku ka përfunduar asfaltimi i rrugës "Ali Hadri" në lagjen "Iliria" të kësaj komune. Kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se kjo komunë është duke u ndërtuar dalëngadalë. "Dalëngadalë Kamenica po ndërtohet. Asfaltimi i rrugës 'Ali Hadri' në lagjen 'Iliria' sot përfundoi, ndërkaj që ne vazhdojmë punën për qytetarët tanë", ka thënë Kastrati. Ndërsa nënkryetari i kësaj komune, Faton Jakupi, ka uruar banorët e kësaj lagje pas përfundimit të asfaltimit të rrugës "Ali Hadri". "Rruga 'Ali Hadri',



lagja 'Iliria'. Edhe kjo rrugë po asfaltohet sot. Urime banorëve të kësaj lagje! Vazhdojmë!", ka thënë Jakupi. Komuna e Kamenicës ka bërë

me dije se asfaltimi i 15 rrugëve lokale është duke u bërë në kuadër të projekteve për ndërtimin e infrastrukturës rrugore nga Ministria e Infrastrukturës.

Komuna e Drenasit largon deponitë ilegale

DRENAS, 11 GUSHT (ER) - Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjente është duke vazhduar aktivitetet për largimin e deponive ilegale në territorin e Komunës së Drenasit. Në vazhden e këtyre punëve kjo drejtori gjatë këtyre ditëve ka larguar deponinë ilegale në

fshatin Verboc, Likoshan dhe Dobroshec. Këto aktivitete do të vazhdojnë me intensitet në hapësirat publike, duke përfshirë gjithë territorin e Drenasit. "Kujdesi ndaj mjedisit që na rrethon, është mbrojtja e shëndetit dhe vendit ku jetojmë", ka njoftuar Komuna e Drenasit.



MOMENTI KËRKON RISHQYRTIMIN E MARRËDHËNIEVE DIASPORË - ATDHE



Shkruan: Bujar BERISHA, Nju-Jork

Në një komunikim me një "intelektual" në Prishtinë gjatë debatit rreth territorit tonë mitik, Çakorrit, ku janë thurur legjenda për trimat dhe trimëreshat tona, ku lotët janë derdhur vadë nga nënat dhe motrat tona duke vajtuar luftëtarët e rënë në mbrojtje të shqiptarisë, "Intelektuali", m'u përgjigj: "Ju jetoni në Nju Jork? Great!" Duke qenë kurioz se "how low" (sa ulët) graviton karakteri qytetar dhe patriotik i këtij zotërie, pas udhëtimit nga Nju Jorku vendosa që ta takojë në hollin e Filologjikut në Prishtinë. Pritjet e mia dolën të sakta. Zotëria nuk pati kohë që t'i ndërrojë disa fjalë miradije, e ofrimi i një kafe siç e ka zakon shqiptari ishte vetëm "wishfull thinking" (për t'u dëshiruar). Fjalja e shpresës dhe krenarisë "mbahu nënë mos ki frikë, se ke djemtë në Amerikë" tanimë ishte një "baddream" (ëndërr e keqe) për të, dhe normalisht zotëria duke qenë se atëherë,

dhe edhe tani është duke "ridinghigh" (në pupa siç thotë populli), larg qoftë, nuk donte që unë apo dikush tjetër që t'ia përmend ato ditë të vështira! Relacioni i këtij "intelektuali", i cili mjerisht graviton "goxha" lart në elitën politike të vendit me një bashkëkombës nga Amerika është treguesi më i mirë i marrëdhënieve Prishtinë-diasporë. Në këto kohë të vështira për vendin këto marrëdhënie në mes të elitës politike në Prishtinë dhe komunitetit jashtëzakonisht të fuqishëm shqiptaro-amerikan janë në nivelin e një "komunikimi teknik". Ky mentalitet i pjesës më të madhe të kësaj elite politike në relacionin Prishtinë-diasporë e ka bazën në hegjemoninë të cilën këta njerëz e ushtrojnë ndaj popullit dhe, si rrjedhojë, edhe ndaj mërgimtarëve. E ndaj mërgimtarëve për ilustrim, para disa ditësh në mjetet e informimit në vend u trumbetua si "big deal" (punë e madhe) heqja e taksës nga qeveria e të ashtuquajturit "kartoni i gjelbër".

Përvjetorët dhe personat e përshtatshëm

Për rreth dy dekada qasja e qeverive të ndryshme gjatë vizitave të tyre në Amerikë në

vazhdimësi funksionon në relacionin darka zyrtare-përvjetorë-darka me dosta dhe njerëz të përshtatshëm. Takime gjithëpopullore të cilat do të afronin më shumë mërgatën me atdheun nuk ka. E dostat e secilës parti përkujdesen që të caktojnë takime sa më domethënëse me politikanë amerikanë në mënyrë që fotografitë dhe videot në të cilat ata janë protagonistët kryesorë, të projektojnë në Kosovë "faktin e pamohueshëm se Uashingtoni është me ta". Nuk ka koordinim afatshkurtër, e as afatgjatë, dhe diplomatët që shërbejnë, në përgjithësi funksionojnë në baza partiake.

Gjeneratat e reja të shqiptaro-amerikanëve nuk pranojnë rol nënshtrues nga Prishtina. Realiteti i ri ku Kosova tanimë është shtet, kërkon një qasje të re nga të dyja anët e Atlantikut. Nevojitet njëri pozicionim i sinqertë dhe një funksionim apolitik nga Prishtina. Duhet ulur në tavolinë dhe të përcaktohen rolet, prioritetet dhe nevojat. Nga komuniteti shqiptaro-amerikan për çdo vit diplomojnë të rinj dhe të reja nga universitetet më prestigjioze. Po shihet se qeveria në Prishtinë nuk ka "nevojë" për këto kuadro. Në anën tjetër Beogradi në 6 muajt

e fundit i ka rekrutuar 22 profesionistë të ndryshëm nga Amerika, Gjermania dhe Franca. Komuniteti shqiptaro-amerikan pret që ndër të tjera të ketë përfaqësues në parlament, pret që të reformohen procedurat për votim, konsultim për çështjet madhore të interesit kombëtar, e refuzojnë qasjen parti-shtet, prezencë të shumëllojshme të shtetit, e mbi të gjitha, nuk pranojnë më rol nënshtrues. Mospranimi i rolit nënshtrues nga mërgata është një bingo për secilin regjim në Prishtinë. I kanë duart edhe më të lira që të praktikojnë nepotizmin dhe korrupsionin. E për të pasur një bashkëpunim të mirëfilltë në mes të Prishtinës dhe mërgatës "it takes two to tango" (për tango nevojiten dy persona...)

Better late than never (më mirë vonë se kurrë)

Klasa politike në Prishtinë me injorancën e tyre patologjike, me qasjet meskine ndaj njëri-tjetrit, e mbi të gjitha paaftësia e tyre në arritjen e një konsensusi minimal në çështjet madhore, bënë që bomba "pa sahat" e pandemisë globale t'ju ekslopojë në fytyrë. Në këtë moment nuk dihet cili problem është më i rrezikshëm; kuleta e

zbrazët apo Covid-19? Është bërë "përrallë mizash" ai 170 euro-shi. Ky virus së shpejti do të kalojë. Por do vijnë viruse dhe rreziqe tjera në të ardhmen. Nuk mbahet shteti me dogana por me zhvillim të mirëfilltë ekonomik. Qeveria e tashme ka mundësinë që në procedura të shpejtuara të krijojë Bankën e diasporës. Mos të thonë se nuk bëhet. Le t'i kërkojnë kredi të butë shtetit norvegjez i cili posedon fondin marramendës 1 trilion dollarësh nga shitja e naftës nga Deti i Veriut. Hapja e degëve të Bankës së diasporës do të mundësonte arritjen e shpejtë të fondeve për familjarët, të cilat me kalimin e kohës do të pësonin rritje. Pas disa muajsh qeveria ka mundësinë që nëpërmjet Bankës së diasporës nga mërgata të kërkojë "hua popullore". Nëpërmjet kësaj huaje qeveria do të ketë një element tëri të stabilitetit financiar. Në fakt, Banka e diasporës do të luante rol strategjik për vendin. E armiqët tanë janë jo vetëm të kënaqur me syrgjynosjen e vazhdueshme të pjesës më vitale të shoqërisë sonë, por ata janë të "shastisur" me syrgjynosjen e mërgatës sonë dhe potencialin e saj politik dhe financiar nga ana e politikanëve në Prishtinë.

SHKOLLAT TË HAPEN MË 1 SHTATOR



Shkruan: Ferat SHALA

Shumica e qeverive në mbarë botën kanë mbyllur përkohësisht institucionet arsimore në përpjekje për ta ndaluar përhapjen e pandemisë Covid-19. UNESCO vlerëson se me këtë veprim janë afektuar mbi një miliard nxënës dhe studentë, ndërkohë që së paku 40 milionë nxënës nuk kanë mbajtur mësim fare. "Bota është në një moment kthese për shkollimin e fëmijëve tanë, vendimet që qeveritë tani marrin do të kenë ndikim të gjatë mbi qindra miliona të rinj dhe në perspektivën e zhvillimit të vendeve të tyre për dekadat e ardhshme", citohet të ketë thënë sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, javën që shkoi.

Vendet e rajonit, edhe Kosova, në fillim të pandemisë kaluan në mësimin në distancë përmes platformës "Youtube" dhe televizioneve kombëtare. Shumë shkolla shfrytëzuan edhe platforma të tjera, pa pagesë, duke iu ofruar nxënësve më shumë interaktivitet si: "Zoom", "Google Meet", "Skype" ose dhe "Microsoft Teams". Megjithatë, shumë nxënës mbetën jashtë "bankave" të shkollës virtuale si pasojë e mungesës së infrastrukturës, qoftë qasjes në Internet apo mungesës së një laptopi në shtëpi. Por tani, pas pushimeve verore, situata ka ndryshuar: numri i rasteve është rritur në formë eksponenciale, globalisht duke arritur mbi 20 milionë të infektuar me virusin Covid-19. Por, në anën tjetër, e kemi ndier edhe efektin e keq të mbylljes, si në aspektin ekonomik apo edhe të mungesës së mësim-nxënies. Krahasuar me vendet e rajonit, vetëm Maqedonia Veriore qëndron më keq se Kosova, për numrin e rasteve të vdekjeve

nga Covid-19 në 1 milion banorë. Pra, situata është serioze dhe me seriozitet duhet të trajtohet. Hulumentimet shkencore, lidhur me mësim-nxënien në kohë të pandemisë, tregojnë që nxënësit, me rastin e rihapjes së shkollave në qershor, janë ndier më mirë sesa "gjatë mësimin online" në shtëpi. Tani më është bërë e ditur që mësimi

online nuk e zëvendëson mësimin në klasë, në asnjë nivel! Prandaj nuk është çudi që tani edhe vendet si Britania e madhe, Norvegjia, Gjermania etj. kanë vendosur ta fillojnë mësimin në shkolla edhe pse fillimisht ishin skeptike në këtë drejtim. Pse Kosova po hesht? Pse Qeveria dhe Ministria e Arsimit ende nuk kanë dalë me

plan konkret për fillimin e vitit të ri shkollor? Apo ndoshta për këtë Qeveria dhe për Ministrinë e Arsimit, hapja e kafiterive është më e rëndësishme se hapja e shkollave? Përgatitjet dhe marrja e masave higjienike dhe sanitare duhet të fillojnë menjëherë, në të gjitha shkollat dhe ato, të gjitha, të hapen më 1 shtator.



Trumpi nxirret papritmas nga konferenca, pas të shtënave pranë Shtëpisë së Bardhë

WASHINGTON, 11 GUSHT - Presidenti amerikan Donald Trump është shoqëruar jashtë sallës ku po mbante konferencë për medie, pasi pranë Shtëpisë së Bardhë ishin dëgjuar të shtëna. Ai është larguar i shoqëruar nga një agjent i Shërbimit Sekret.

Agjenti ka dalë në skenë derisa presidenti Trump po fliste dhe i pëshpëriti në vesh.

Trumpi është dëgjuar duke i thënë atij: "Oh!" dhe "çfarë po ndodh". Shtëpia e Bardhë është vendosur në izolim gjatë incidentit të së hënës. Presidenti është kthyer në konferencë për media nëntë minuta më vonë për të thënë se situata ishte nën kontroll dhe një njeri ishte qëlluar. Presidenti Trump u ka thënë

gazetarëve se ai besonte se shërbimi sekret i ShBA-së kishte qëlluar një të dyshuar, i cili ishte i armatosur. Shërbimi Sekret Amerikan e ka konfirmuar incidentin. "Një burrë u qëllua nga një oficer i shërbimit sekret më 10 gusht jashtë rrethojave të Shtëpisë së Bardhë pasi ai iu afrua oficerit dhe i tha që kishte një armë", ka thënë Shërbimi Sekret Amerikan.

Burri, i identifikuar vetëm si një 51-vjeçar, është goditur në kraharor, ka thënë shërbimi sekret në një deklaratë të postuar në "Twitter". I dyshuari dhe oficeri janë transportuar në spital. Që nga protestat në fund të majit dhe qershorit, masat e sigurisë janë shtuar rreth Shtëpisë së Bardhë. Presidenti, i cili është duke kërkuar



rizgjedhjen më 3 nëntor, ka thënë se të shtënat "nuk mund të kishin asnjë lidhje me të".

Gjithashtu, ai ka vlerësuar mbrojtjen e ofruar nga Shërbimi Sekret. "Ata janë më të

mirët nga më të mirët. Ata janë shumë të trajnuar", ka thënë Trumpi.

Liderja opozitare në Bjellorusi largohet nga vendi



MINSK, 11 GUSHT - Liderja e opozitës në Bjellorusi, Svetlana Tikhanouskaya, ka udhëtuar në Lituani dhe është e sigurt, ka thënë ministri i Jashtëm i Lituanisë, Linas Linkevičius, në një postim në llogarinë e vet në "Twitter".

Tikhanouskaya ka dalë si rivalja kryesore e Aleksandër Lukashenka në zgjedhjet presidenciale të së dielës. Ekipi i saj nuk ishte në gjendje të kontaktonte me të në telefon të hënën, pasi ajo ishte larguar nga ndërtesa e komisionit zgjedhor. Më herët ajo u ka thënë gazetarëve se jo Lukashenka, por ajo i ka fituar

zgjedhjet. Të paktën një person është vrarë, dhjetëra të tjerë janë plagosur dhe më shumë se njëqind demonstrues janë arrestuar të dielën në mbrëmje dhe herët të hënën në mëngjes, gjatë trazirave në rrugët e Minskut dhe qyteteve të tjera në Bjellorusi. Forcat e sigurisë janë përleshur me mbështetësit e opozitës, të cilët nuk i njohin rezultatet e zgjedhjeve, që i ka fituar bindshëm presidenti aktual, Aleksandër Lukashenka.

Svyatlana Tsikhanouskaya ka thënë në një konferencë për media se ajo nuk i njeh rezultatet. Tikhanouskaya ka

vendosur të garojë në zgjedhje, pasi bashkëshorti i saj është ndaluar të kandidojë dhe është arrestuar në fillim të këtij viti. Autoritetet shtetërore e kanë akuzuar burrin e Tikhanouskayas, Syarhey Tsikhanouski, për bashkëpunim me mercenarët rusë, për të shkakuar trazira përpara zgjedhjeve. Tikhanouskaya i ka hedhur poshtë akuzat. Presidentja e Komisionit Evropian Ursula van der Leyen ka dënuar dhunën kundër protestuesve në qytetet bjelloruse. Lukashenka është në krye të Bjellorisë që nga viti 1994.

Putini njofton se Rusia ka zhvilluar një vaksinë për luftimin e koronavirusit

MOSKË, 11 GUSHT - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka thënë se një vaksinë për luftimin e koronavirusit e zhvilluar në Rusi është e gatshme për përdorim dhe se njëra nga vajzat e tij është vaksinuar. Putini e ka bërë këtë njoftim në një takim të qeverisë më 11 gusht, duke theksuar se vakcina është treguar efikase gjatë testimit dhe mund të krijojë imunitet të qëndrueshëm nga koronavirusi. Më shumë se 100 vakcina të mundshme janë duke u zhvilluar në botë dhe të paktën katër nga të janë në fazën finale të testimit në njerëz. Faza e tretë e testimit

përfshin miliona njerëz dhe procesi zgjatë për disa muaj, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Rusia është shteti i parë që ka regjistruar një vaksinë për mbrojtje nga koronavirusi. Por, shkencëtarët në Rusi dhe vende të tjera janë shfaqur skeptikë dhe e kanë vënë në pyetje vendimin për të lansuar vaksinën para përfundimit të fazës finale të testimit. OBSH-ja javën e kaluar ka kërkuar nga Rusia që t'i ndjekë të gjitha metodat e nevojshme dhe fazat që çojnë në zhvillimin e një vaksine të sigurt. Por, Putini ka insistuar se vakcina ruse ka

kaluar të gjitha testet e nevojshme dhe se njëra nga vajzat e tij pas vaksinimit po ndihet shumë mirë. "Shpresoj se do të jemi në gjendje të fillojmë me prodhim në masë në të ardhmen e afërt", ka thënë Putini. Qeveria ruse ka thënë se punëtorët shëndetësorë, mësimdhënësit dhe personat që bëjnë pjesë në kategorinë më të rrezikuar, do të kenë përparësi për vaksinim. Rusia ka regjistruar 860 mijë raste me koronavirus, vendi i katërt në botë me numrin më të madh të të infektuarve dhe më shumë se 14 300 viktima, sipas statistikave të Universitetit "John Hopkins".







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients


[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E jashtëzakonshme

NASA zbulon një fotografi të mahnitshme të Jupiterit që duket si pica



NASA ka ndarë një imazh mahnitës të Jupiterit që duket si pica. Pikat rrethore në planet janë ciklonet në Polin e Veriut të Jupiterit, por do t'ju bëjë të mendoni se ky ishte një imazh me rezolucion të lartë të drekës së dikujt. Anija kozmike e NASA-s "Juno" ka kapur imazhin e planetit të stuhishëm. Agjencia hapësirnore amerikane e ka publikuar këtë foto në "Instagram". Ka marrë mbi një milion pëlqime dhe shumë njerëz kanë komentuar duke e krahasuar imazhin me ushqimin. Një përdorues në "Instagram" ka shkruar: "Mendova se kjo ishte një pica".

BARSOLETA E DITËS



Gruaja: Zemër, do ta padis taksistin në gjykatë.
Burri: Pse?
Gruaja: Sot në dy raste për pak sa nuk më shtypi me veturë.
Burri: Mos u ngut zemër. T'i japim edhe një rast.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje




FOTO E DITES



Çaste fantastike janë skalitur në objektivin e aparatit fotografik. Delfinë në gjirin e Ftelese në kanalën e Korfuzit afër Ksamilit. /LSA/

E rrallë

Planeti xhuxh më i afërt me Tokën është botë ujore

Ceres, planeti xhuxh më i afërt me Tokën, është një botë ujore dhe mund të ketë një rezervuar të gjerë me ujë të kripur të fshehur nën sipërfaqen e tij. Të dhënat vijnë nga një punë e re kërkimore, sipas së cilës, rezervuari në këtë planet të vogël, që orbiton Diellin mes Marsit dhe Jupiterit, shtrihet nën kraterin 20 milionë vjeçar të njohur si Occator dhe mund të ketë jetë. Të dhënat bazohen në analizimin e imazheve të anijes kozmike "Dawn" të NASA-s, që ka vëzhguar sipërfaqen e Ceres. "Dawn" ka orbituar Ceres, që është rreth 965 kilometra rreth e rrotull, mes 2015-s dhe 2018-s derisa ka mbaruar karburanti. Dr. Carol Raymond, drejtuese e këtij misioni, ka thënë se të dhënat sugjerojnë se Ceres është një botë oqeanike dhe mund të ketë qenë gjeologjikisht aktive në vitet e fundit. Grupi i punës beson se rezervuari i kripur i gjetur në sipërfaqe të planetit xhuxh mund të jetë krijuar nga impakti që ka krijuar kraterin. Kjo ka çuar në formimin e depozitave të kripës në sipërfaqe të planetit, që në distancë duken si njolla të shndritshme.



DASHI

Falë gatishmërisë për të eksperimentuar, për t'u zgjeruar në kontekste të reja, do të shihni se ëndrrat tuaja do të realizohen, madje edhe atë më ambicioze.

imagjinata dhe besimi që keni në vete. Mërkuri mund t'i ngatërrojë idetë tuaja dhe qëllimet e mira që keni.



DEMI

Të etur dhe të gatshëm për t'i ndihmuar të tjerët. Ju ndieni kënaqësi kur bëni mirë dhe merrni vlerësime njerëzitet përreth.

Të etur dhe të gatshëm për t'i ndihmuar të tjerët. Ju ndieni kënaqësi kur bëni mirë dhe merrni vlerësime njerëzitet përreth.



BINJAKËT

Ditë interesante, e përbërë nga kënaqësi të vogla dhe të thjeshta mes miqve të vjetër dhe të rinj.

Ditë interesante, e përbërë nga kënaqësi të vogla dhe të thjeshta mes miqve të vjetër dhe të rinj.



GAFORRJA

Është shumë e mençur ta pranoni ftesën e atyre që ju premtojnë bashkëpunim, miqësi dhe ndihmë.

Është shumë e mençur ta pranoni ftesën e atyre që ju premtojnë bashkëpunim, miqësi dhe ndihmë.



LUANI

Qëllin tuaj falë yjeve të kësaj periudhe të bukur. Do të përballeni me efekte pozitive në shumë sektorë.

Qëllin tuaj falë yjeve të kësaj periudhe të bukur. Do të përballeni me efekte pozitive në shumë sektorë.



VIRGJËRESHA

Marrëdhënia në çift do të jetë e shkëlqyer dhe do të jeni të mbushur me shumë dashuri. Yjet sot do t'ju mbushin me energji pozitive.

Marrëdhënia në çift do të jetë e shkëlqyer dhe do të jeni të mbushur me shumë dashuri. Yjet sot do t'ju mbushin me energji pozitive.



PESHORJA

Përdorni mirë mbrojtjet astrale për të lehtësuar, modifikuar dhe përmirësuar punët familjare dhe marrëdhëniet.

Përdorni mirë mbrojtjet astrale për të lehtësuar, modifikuar dhe përmirësuar punët familjare dhe marrëdhëniet.



AKREPI

Besimi juaj i madh, gëzimi që keni përbrenda, jua bëjnë ditët më të lumtura. Shprehni ndjenjat me natyralitet dhe entuziazëm, larg anktheve të zakonshme.

Besimi juaj i madh, gëzimi që keni përbrenda, jua bëjnë ditët më të lumtura. Shprehni ndjenjat me natyralitet dhe entuziazëm, larg anktheve të zakonshme.



SHIGJETARI

Shprehni ndjenjat me natyralitet dhe entuziazëm, larg anktheve të zakonshme.

Shprehni ndjenjat me natyralitet dhe entuziazëm, larg anktheve të zakonshme.



BRICJAPI

Shprehni ndjenjat me natyralitet dhe entuziazëm, larg anktheve të zakonshme.

Shprehni ndjenjat me natyralitet dhe entuziazëm, larg anktheve të zakonshme.



UJORI

Shprehni ndjenjat me natyralitet dhe entuziazëm, larg anktheve të zakonshme.

Shprehni ndjenjat me natyralitet dhe entuziazëm, larg anktheve të zakonshme.



PESHQIT

Shprehni ndjenjat me natyralitet dhe entuziazëm, larg anktheve të zakonshme.

Shprehni ndjenjat me natyralitet dhe entuziazëm, larg anktheve të zakonshme.

Dua Lipa zhvendoset në Los Anxhelos për të dashurin e saj



Dua Lipa ka ngritur “shkopinjte” dhe ka udhëtuar përtej oqeanit për në Los Anxhelos për të qenë sa më afër të dashurit të saj, Anwar Hadid, sipas raporteve të reja. “The Sun” ka raportuar se këngëtarja 24-vjeçare është zhvendosur në ShBA për të jetuar me të dashurin e saj modeluesin, 21 vjeç,

në mes të frikës se nuk do të mund të udhëtojë dhe të shkojë më për shkak të pandemisë së koronavirusit. Është pohuar se Dua ka marrë një pronë të pasur në Beverly Hills afër familjes së të dashurit të saj, përkundër faktit se familja e saj janë të gjithë me bazë në Mbretërinë e Bashkuar.

Kejvina ngacmon imagjinatën me fustanin e shkurtër



Kejvina Kthella sërish në qendër të vëmendjes. Ajo është një nga modelet më “in” në shoubizin shqiptar dhe Kejvina ka vazhduar ta tërheqë vëmendjen me imazhet e publikuara. Bukuroshja ka publikuar një fotografi në llogarinë e vet në

“Instagram”, ku shfaqet me një minifund i cili i nxjerr në plan të parë këmbët seksi të modelueses. Është folur shumë që pas “Xing me Ermalin” do ta shohim atë me një tjetër emision, por një gjë e tillë ende nuk është konkretizuar.



Elena Ora “sfidon” Ritën në pozat ku shfaqet vetëm me reçipeta

Bukuroshet me prejardhje shqiptare, Elena dhe Rita Ora, po vazhdojnë t’i shijojnë pushimet në Ibiza të Spanjës. Motrat, të cilat shquhen për fizikun e bujshëm dhe atraktiv, gjatë këtyre ditëve kanë publikuar imazhe dhe video të ndryshme në rrjetet sociale. Të martën ka qenë Elena, ajo e cila ka arritur të rrembejë vëmendje të madhe me pozat e reja që ka hedhur në “Instagram”. Ajo ka pozuar pranë një makine

luksoze e veshur me sytjena të bardha e këmishë të po së njëjtës ngjyrë. Me dukjen glamuroze e po aq të thjeshtë, motra e yllit shqiptar vjen në formë të mrekulueshme. “Mirëmëngjesi për të gjithë”, ka qenë përshkrimi që ka zgjedhur për këto fotografi duke treguar se sapo ka nisur ditën. Elena përndryshe ka një raport shumë të mirë me të motrën Ritën dhe tashmë njihet si menaxherja e saj.

Ronaldo sërish në qendër të vëmendjes me fizikun muskolor

Ndërkohë që po i shijon pushimet me familjen, Cristiano Ronaldo ka tërhequr interesimin e faqeve rozë me pozat e shpërndara në rrjetet sociale. 35-vjeçari, partnerja e tij Georgina Rodriguez dhe fëmijët janë duke kaluar çaste argëtimi në jahtin e tyre luksoz që ka vlerën rreth gjashtë milionë euro. Ndërsa krahas modelueses që merr vëmendjen sa herë që publikon imazhe në rrjetet sociale, edhe superylli i Juventusit përfollet në faqet rozë. Ronaldo është i njohur për kujdesin e vazhdueshëm për fizikun e tij, prandaj sa herë që publikon fotografi që tregojnë figurën e tij muskulore merr pëlqime të shumta.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Klubet e Superligës vazhdojnë përforcimet



Disa prej klubeve elitare në futboll si Llapi, Prishtina dhe Arbëria janë përforcuar me futbollistë të rëndësishëm për edicionin e ri. Risi ishte transferimi i sulmuesit malazez Sava Gardasheviq në skuadrën e drejtuar nga Tahir Batatina

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 GUSH - Klubet e IPKO Superligës së Kosovës në futboll po vazhdojnë të përforcohen në këtë afat kalimtar. Klubi i Llapit që drejtohet nga trajneri Tahir Batatina e ka prezantuar sulmuesin nga Podgorica, Sava Gardasheviq, i cili ka nënshkruar për një vit, me mundësi rinovimi. 27-vjeçari ka një karrierë të madhe pas vetes, duke numëruar kështu mbi 109 ndeshje për skuadrat nga Mali i Zi. Karrierën e futbollistit Gardasheviq e ka filluar në skuadrën Budućnost Podgorica, ndërsa është paraqitur edhe për skuadrat e tjera nga Mali i Zi si: FK Mornar Bar, FK Deqiq Tuzi e, së fundmi, te Kom Podgorica, ku në 52 paraqitje arriti të realizojë 16 gola. Po ashtu, vlen të ceket se sulmuesi i ri i Llapit ka qenë edhe reprezentues i Malit të Zi për grupmoshën U19. "Sava Gardasheviq menjëherë pas nënshkrimit të kontratës me Llapin është vënë nën urdhrat e trajnerit Tahir Batatina, i cili shpreson se ai do të jetë formula e shënimit të golave për edicionin e ri të Superligës", thuhet në njoftimin e skuadrës së Llapit. Edhe skuadra e Prishtinës ka qenë aktive të martën pasi ka arritur marrëveshje trevjeçare me futbollistin e ri të talentuar, Albin Prapashtica, i cili është nga akademia e 2 Korrikut. Ish-anëtari i përfaqësueses së Kosovës

U17 ka shënuar gol kundër Holandës në kualifikime, si dhe ndaj përfaqësuesve të Irlandës U17. Ndërsa me përfaqësuesen e Kosovës U19 ka shënuar edhe ndaj Anglisë në turne në Itali, si dhe dy gola Maltës. Ka luajtur edhe në kualifikimet e U19 me Kosovën. Së fundi ishte në prova edhe te skuadra e madhe kroate, Dinamo Zagreb. "Kënaqësi, privilegj dhe nder t'i mbroj ngjyrat e skuadrës më të madhe në vend. Jam mirënjohës për udhëheqjen e klubit që më kërkuan, më besuan dhe më bindën të jem pjesë e projektit të klubit. Jam shumë i bindur se kam zgjedhur adresën e duhur të parë të madhe të zhvillimit tim profesional në karrierën time prej futbollisti. Kam shumë për të mësuar e për t'i dhënë klubit tim të ri, në veçanti 'Plisave', ka thënë Prapashtica për faqen zyrtare të Prishtinës.

Edhe klubi i inkuadruar për herë të parë në Superligë, Arbëria, është përforcuar me futbollistin me përvojë të madhe, Labinot Ibrahimimi. Ky i fundit ishte pjesë e Prishtinës, por pas përfundimit të kontratës nuk gjeti gjuhë të përbashkët me klubin kryeqytetas dhe vendosi që karrierën ta vazhdojë në skuadrën nga Lipjani. "Ibrahimimi, një lojtar profesional, me përvojë të jashtëzakonshme, përfaqësonte skuadra të shumta si: Ulpiana, Arbëria, Partizani dhe, së fundi, fituesin e Kupës së Kosovës, FC Prishtina. Ibrahimimi do ta bartë ndërresën kuq e zi te KF Arbëria dhe do

ta ndihmojë skuadrën në repartin defanziv", thuhet në njoftimin e skuadrës së Arbërisë. "Presidenti i klubit së bashku me kryesinë e KF Arbëria i dëshirojnë shëndet dhe suksese duke u shprehur optimist se së bashku do t'i dhurojnë më të mirën klubit", thuhet në njoftimin e këtij klubi.

Labinot Qosa emërohet trajner i portierëve në KF Ballkani

Skuadra e Ballkanit e ka përforcuar shtabin teknik me ish-portierin e njohur Labinot Qosën, i cili do të jetë trajner i portierëve në ekipin e parë. "Trajneri i mirënjohur ka arritur marrëveshje me klubin që ta ushtrojë detyrën e trajnerit të portierëve për ekipin e parë dhe të këshillojë/asistojë shkollën e futbollit për ngritjen e kapaciteteve për sa iu përket portierëve. Labi është i ri në moshë, por i pasur në bagazh si portier dhe trajner. Ai ka punuar si trajner në KF Hajvali, KF Llap dhe KF Flamurtar. Gjithashtu, është trajner i përfaqësueses së Kosovës U/19 femrat. Labi si portier profesionist - aktiv ka mbrojtur në klube si KF Llapi, KF Besiana, KF KEK, KF Kosova e Prishtinës, Renova - Tetovë dhe përfaqësuesen e Kosovës A gjatë vitit 2005", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

SHKURT

Bërbatovci largohet nga Besa

Sulmuesi i njohur në futbollin e Kosovës, Florim Bërbatovci, ka njoftuar se është larguar nga skuadra e Besës së Pejës. Bërbatovci ishte një nga lojtarët kryesor në klubin pejan gjatë rrugëtim-it për t'u rikthyer në IPKO Superligë. "Më nuk jam pjesë e FC Besa. Falënderoj kryetarin Shkumbim Gashi, gjithashtu edhe kryesinë e re, në veçanti trajnerin edhe bashkëlojtarët për një vit të suksesshëm. Faleminderit tifozëve për mbështetjen! Suksese në Superligë FC Besa", ka shkruar Bërbatovci.

Pesë lojtarë të Gjilanit, pozitivë me Covid-19

Rastet me koronavirus vazhdojnë të jenë çështje te skuadrat e Kosovës. Pas anulimit të ndeshjes së Dritës me Linfield shkaku i rasteve me Covid-19 te skuadra e Kosovës, është tani skuadra e Gjilanit që po ballafaqohet me të njëjtin problem. Te Gjilani pesë futbollistë kanë rezultuar pozitivë, para ndeshjes kualifikuese për Ligën e Evropës. Ndeshja e Gjilanit kundër Tre Pennes të San Marinos luhet më 20 gusht. Mbetet të shihet se çfarë do të ndodhë në testet që UEFA i zhvillon para ndeshjeve.

Silva, afër Lazios

Futbollisti spanjoll David Silva pritet të nënshkruajë me skuadrën e Lazios në Serinë A pas përfundimit të Ligës së Kampionëve. Lajmi është bërë me dije nga "Tuttomercatoweb", të cilët shkruajnë se kanë mbetur vetëm detajet e fundit për t'u sqaruar. Kontrata e Silvas te Lazio pritet të jetë trevjeçare, me vlerë 3.5 milionë euro plus bonuse. 34-vjeçari është pjesë e Manchester Cityt nga viti 2010.

Shkarkohet Donadoni

Aventura e Roberto Donadonit në Kinë nuk ka shkuar siç duhet. Mediat në Itali raportojnë se tekniku italian është shkarkuar nga Shenzen FC, pas nisjes jo të mirë të kampionatit këtë sezon. Tri humbje nga katër ndeshje i kanë bindur drejtuesit e klubit kinez të vendosin për shkarkimin e trajnerit të njohur, i cili sezonin e shkuar ishte renditur në vendin e parafundit në krye të Shenzen. Tekniku 57-vjeçar, i cili në të shkuarën ka drejtuar edhe kombëtaren e Italisë, tani duhet të mendojë për një tjetër aventurë, ndoshta në vendin e tij, ku për herë të fundit ka qenë në krye të skuadrës së Bolognas.

Hamiltoni: Bottas dhe Verstappen janë rivalët e mi për titull

LONDËR, 11 GUSHT - Vendi i dytë në garën e katërt sezonale të Botërorit 2020 të Formulës 1 i dha mundësi Lewis Hamiltonit të shkojë në 34 pikë avantazh në renditje ndaj shokut të tij të skuadrës

Valtteri Bottas. Gjithsesi, mes dy pilotëve është holandezi Max Verstappen, që ka 30 pikë diferencë pas triumfit në Silverstone. "Në garat e fundit po shohim një problem me gomat, por besoj se skuadra

do ta zgjidhë këtë çështje, që të mos krijohet sërish në të ardhmen", ka thënë Hamilton. "Botërori është ende në hapat e para dhe është shpejt për të folur për titull. Duke parë që Ferrari ka

probleme, mendoj se Bottas e Verstappen do të jenë dy rivalët e mi kryesorë për titull, me të cilët do të duelojmë në çdo garë. Gjithsesi, duhet kujdes në çdo garë", ka deklaruar Hamiltoni.



Anulohet ndeshja Drita - Lienfield, shkak Covid-19

PRISHTINË, 11 KORRIK - UEFA e ka anuluar ndeshjen e Ligës së Kampionëve në mes të Dritës dhe Lindfieldit, pasi edhe një tjetër futbollist i Dritës ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Ndeshja ishte paraparë të zhvillohet në Nyon të Zvicrës, në "Colovray Stadium" nga ora 18:00 në pasditen e së martës. "Pas vendimeve nga autoritetet zvicerane të shëndetit, në bashkëpunim me UEFA-n, e gjithë skuadra e Dritës është në karantinë, pasi edhe futbollisti i dytë i Dritës ka rezultuar pozitiv me Covid-19, para ndeshjes me Lindfieldin të planifikuar për 11 gusht, nga ora 18:00 në Nyon të Zvicrës dhe e njëjta nuk mund të luhet. Futbollisti që rezultoi pozitiv dje, kishte rezultuar negativ në testimet e së premtes, ashtu si edhe e gjithë skuadra e Dritës kishin rezultuar negativ me të ardhur



në Zvicër. Tani çështja do të shqyrtohet nga Komiteti i Etikës së UEFA-s për një vendim të mëtutjeshëm", thuhet në njoftimin e UEFA-s. Për anulimin e ndeshjes ka njoftuar edhe Drita në faqen zyrtare të saj: "Ju njoftojmë që ndeshja finale e paraparë të zhvillohet sot në orën 18:00

me kampionin e Irlandës së Veriut, Linfield është anuluar. Vendimi është marrë nga autoritetet zvicerane për shkak që në testimin e fundit një lojtar i klubit tonë ka rezultuar pozitiv! Vendimi për fatin e ndeshjes do të merret në ditët në vijim nga komisioni i disiplinës".

Milwaukee pëson humbje ndaj Torontos, Lakersat mposhti Denverin

ORLANDO, 11 GUSHT - Toronto Raptors tregoi forcën ndaj Milwaukee Bucksit në përplasjen mes dy ekipeve më të mira të Lindjes, duke fituar me rezultatin 114-106. Kanadezët, edhe pse kishin mungesa të shumta (Kyle Lowry, Fred VanVleet e Serge Ibaka), shfrytëzuan faktin që te Bucksit nuk ishte i pranishëm "ylli" i skuadrës, Giannis Antetokounmpo, i cili i ishte nënshtruar një ndërhyrje dentare. Një sfidë e ekuilibruar në pjesën e parë, por Raptorsi mori një epërsi të konsiderueshme në periodën e tretë dhe në fillim e 12-minutëshit të fundit shkuan deri +22 pikë, diferencë që rezultoi e parikuperueshme për Bucksin, me gjithë përpjekjet në minutat e fundit. Statistikat tregojnë që tre shënuesit më të mirë i përkasin skuadrës kanadeze: Bucher, Thomas e Pawell, respektivisht me 25, 22 dhe 20 pikë. Pavarësisht kësaj disfate, Bucksit mbeti në krye të Konferencës së Lindjes me katër fitore me shumë se Raptorsi. Një përballje plot



rivalitet u zhvillua mes Los Angeles Lakersit dhe Denver Nuggetsit, por në momentin më vendimtar të sfidës, në minutat e fundit, kalifornianët morën kryesimin duke triumfuar me vetëm tri pikë diferencë, 124-121. Merita kryesore në këtë sukses të Lakersit ishte e LeBron Jamesit, autor i një "double double", 29 pikë dhe 12 "rebounde", pa harruar

ndihmën që dhanë Davis dhe Kuzma me 27 dhe 25 pikë. Indiana Pacers nuk ia doli ta merrte fitoren e radhës përballë Miami Heat, në sfidën mes vendit të katërt dhe të pestë. 114-92 triumfoi skuadra nga Florida, e udhëhequr nga Jimmy Butler, që shënoi 19 pikë dhe rikuperoi 11 topa. Heat merr vendin e katërt në Lindje me një fitore më shumë se Pacersi.

SHKURT

Dy raste pozitive me Covid-19 te Valencia

Raste të reja me koronavirus në klubet spanjolle. Valencia ka njoftuar se dy individë kanë rezultuar pozitivë në testimin për këtë virus. Ditë më parë Atletico Madridi njoftoi për dy raste me Covid-19, ndërsa tash e njëjta gjë u ka ndodhur edhe Los Che. Klubi spanjoll ka bërë me dije se dy të infektuarit janë të izoluar në shtëpitë e tyre, ndërsa tash për tash nuk është bërë me dije identiteti. Valencia nuk është më pjesë e garave evropiane këtë sezon, pasi që ishte eliminuar nga Atalanta në Ligën e Kampionëve. Nga ana tjetër, Atletico mësoi se Angel Correa dhe Sime Vrsaljko janë infektuar me koronavirus, vetë disa ditë para ndeshjes çerekfinale ndaj RB Leipzig.

Sturridge kërkon rikthimin në Premierë Ligë

Daniel Sturridge kërkon rikthimin në Premierë Ligë pasi përfundoi pezullimin katërmujor për shkeljen e rregullave të bastvënies. Sulmuesi 30-vjeçar dëshiron të luajë sërish në elitën e futbollit anglez që, sipas tij, është një mision që për të ende nuk ka përfunduar. Aventura e tij e fundit ishte në Turqi me Trabzonsporin, por kontrata u mbyll me marrëveshje marsin e kaluar dhe tashmë Sturridge po pret ofertën e duhur. Sipas lojtarit, ofertat për të kanë ardhur nga klubet më të rëndësishme në Evropë e jashtë saj, por insiston të luajë sërish në Premierë Ligë.

Areola rikthehet te PSG-ja

Real Madridi ka njoftuar se huazimi i Alphonse Areola ka përfunduar. "Los Blancos" huazoi portierin francez për një sezon, pasi shiti Keylor Navas drejt Paris-Saint Germainit. Areola tash do të kthehet te PSG-ja, klub ky që ka pronësinë e lojtarit. 27-vjeçari bëri katër paraqitje në La Liga, 2 në Ligën e Kampionëve dhe 3 në Kupën e Mbretit me Realin.

De Ligt mungon tre muaj

Juventusit nuk do të ketë gati për tre muaj mbrojtësin e tij Matijs De Ligt. Futbollisti holandez do të operohet brenda kësaj jave në shpatullën e djathtë. Pas përfundimit të fushatës së bardhezinjve në Ligën e Kampionëve teksa u eliminuan nga Lyonit, 20-vjeçari është i vendosur ta kurojë dëmtimin e pësuar në shpatullën e djathtë dhe të mos më tepër kohë se tre muaj rehabilitim. Megjithëse Juventusit ka në dispozicion Demiralin, Chiellinin dhe Bonnucin, De Ligt konsiderohet një pikë referimi për të ardhmen.

Immobile: Do të qëndroj përjetë te Lazio

Golashënuesi më i mirë në Serinë A dhe fitues i "Këpucës së Artë" në Evropë, Ciro Immobile nuk e ka ndërmend të largohet nga Lazio. Immobile shpërtheu nën drejtimin e Simone Inzaghit, duke shënuar emrin në regjistrin e artë të futbollit italian. "Kam ndërmend të lidhem përgjithmonë me Lazion. Rinovimi do të jetë tre vjet, kështu që kontrata do të skadojë në vitin 2025, kur të bëhem 35 vjeç. Para se të mbërrija te Lazio, kontaktet me Napolin ishin të shpeshta, por për një arsye apo një tjetër nuk u arrit marrëveshja. Napoli është qyteti ku unë kam lindur, gjithmonë e ndjek Napolin me dashuri, por ajo që Lazio më ka dhënë dhe po më jep është e paçmueshme", ka deklaruar Immobile në një intervistë për "Corriere dello Sport".

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Agro Elementare”,L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 70787822, nr. fis. 600722856 dhe ka caktuar likuidatorin Shaban Ismajli me nr tel. 044-194-334, për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Agro Elementare”,L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 70787822, nr. fis. 600722856, ujedno imenovao Likvidatora Shaban Ismajli me nr tel. 044-194-334 o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Agro Elementare”,L.L.C.. has come to the decision to quit its business: 70787822, nr. fis. 600722856 the company has appointed a liquidator Shaban Ismajli me nr tel. 044-194-334 who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DATA/DATUM/DATE	10.08.2020
NR/BR.	zyrtarisht
PËR/ZA/TO	Për kandidatët e interesuar për aplikim në konkursin nr. 01-46/20, të datës 24.07.2020
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM	z. Agim Aliu Kryetar i Komunës
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Njoftim për zgjatjen e afatit për aplikim në konkursin nr. 01-46/20, të datës 24.07.2020

Njoftohen kandidatët e interesuar për aplikim në konkursin nr. 01-46/20, të datës 24.07.2020, se për shkak të mos arritjes së numrit të mjaftueshëm të kandidatëve, zgjatet afati për aplikim edhe për 5 (pesë) ditë kalendarike, për plotësimin e këtyre vendeve të punës:

2. Udhëheqës Artistik;
3. Dramaturg;
4. Garderobier dhe
5. Ndhimës realizues i skenografisë dhe shtëpiak.

Andaj në bazë të asaj që u tha më lartë, aplikantët e interesuar për punësim nga të gjitha komunitetet e Kosovës kanë të drejtë aplikimi nga data 10.08.2020 deri më datën 14.08.2020.

Me respekt!

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “101 Shërbime”, SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 811310060 dhe ka caktuar likuidatorin Shaban Ismajli me nr. tel. 044-194-334, për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “101 Shërbime”,L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 811310060, ujedno imenovao Likvidatora Shaban Ismajli me nr tel. 044-194-334 o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “101 Shërbime”,L.L.C.. has come to the decision to quit its business: 811310060 the company has appointed a liquidator Shaban Ismajli me nr tel. 044-194-334 who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► “MS Grup” SH.A. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71339920/601714696.

► Sheadin Kadrijaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Leke Dukagjini " Prizren.

► Gezim Hoti shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Bajram Curi " Krush e Madhe.

► Feti Ajazaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► “Agro Elementare” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70787822/600722856.

► N.T.P. “Besarti” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 80379714/ 600194774.

► Valon Daci shpalle te pavlefshme Diplomën e Sh.M.L "Dardania" Hani Elezit.

► Florim Suma shpalle te pavlefshme Diplomën e Sh.M.L "Dardania" Hani Elezit.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministarstvo Obrazovanje za Nauku,
Ministry Education of Science

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog
Sekretara/Office of the General Secretary

NJOFTIM

Anulohet pika e 6 e konkursit, një (1) psikolog në Qendrën Burimore "Nënë Tereza" në Mitrovicë dhe një (1) psikolog në Qendrën Burimore në "Xheladin Deda" në Pejë, të shpallur me datë 15.07.2020, për vendet e lira të punës në Qendrat Burimore. Pika tjetër e konkursit vazhdojnë me procedurat e rekrutimit.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë - Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. - Prishtinë, me datë 12.08.2020, **SHPALLË:**

KORRIGJIMIN E KONKURSIT PUBLIK

I. Titulli i vendit të punës: Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit (1 pozitë):

II. Numri i referencës: NPL -D.T. 07/08/20/2:

III. Detypat dhe përgjegjësitë:

Zyrtari përgjegjës i prokurimit (ZPP) është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK brenda kompetencave të tij dhe në pajtim me dispozitat e LPP. ZPP përveç obligimeve tjera ka përgjegjësi të vijim: a) Në konsultim me të gjitha departamentet përgatit një plan vjetor të prokurimit. Kur është e mundur siguron që artikujt e përdorimit të zakonshëm janë konsoliduar; b) Siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrë më ekonomike, efektive dhe efektive; c) Përfaqëson dhe siguron se në specifikimet teknike nuk ka kufizime në konkurrencë; d) Këshillon njësitë kërkuese, për metoda dhe praktika përkatëse të prokurimit; e) Në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese, koordinon të gjitha dokumentet, specifikimet, Te Paramasat dhe Parallogaritë dhe vizatimet; f) Organizon dhe menaxhon aktivitetet e prokurimit; g) Rekomandon përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve; h) Partecipon në Negocime të Tenderëve dhe siguron rezultate të drejta; i) Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shqyrton propozimin për kontratë të rekomanduar nga komisioni vlerësues; j) Pranon/refuzon rekomandimin e propozuar; k) Nënshkruan kontratat pas rikonfirmimit që informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht; l) Kur ndodhin mosmarrëveshje, dëme në mallra, dorëzime të tepërta ose të mangëta, dëshim në performim ose komplikime tjera relevante, ruan të gjitha komunikimet dhe dëshmitë relevante të pranuar; m) Përcjell dëshmitë e kontraktorëve të cilët kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre kontraktuale kurdo që informohet nga Menaxheri i Projektit në lidhje me kompensimet e duhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave; n) Prodhon një raport vjetor në fund të secilit vit fiskal për kontratat e nënshkruara. n) Kryen punë dhe detyra tjera të urdhëruar nga Mbikëqyrësi.

IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit

- Kërkesa për punësim (aplikacioni);
- Letër motivuese;
- Dëshmi për shkollimin e noterizuar;
- Dëshmi për përvojën e punës nga (punëdhënësit, nga Trusti Pensional dhe nga ATK-ja);
- Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo për vepra të tjera;
- Certifikata e mjekut;
- Certifikata se keni zotësi të veprimit;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Adresa e vendbanimit;
- Nr. i telefonit kontaktues si dhe
- E-maili kontaktues;

V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës

- Diploma e noterizuar e kualifikimit superior;
- Certifikatë valide, bazike apo të avancuar të prokurimit e noterizuar;
- Tre (3) vjet përvojë pune në vendin e punës, zyrtarë përgjegjës i prokurimit;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;
- Njohuria obligative e kompjuterit.

VI. Kohëzgjatja e emërimit:

- Kontratë për punë dhe detyra specifike.

VII. Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendari dhe atë nga data e publikimit.

VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim:

- Aplikacionet për punësim mund të merren fizikisht në zyrën e Departamentit të Administrimit Qendror dhe të njëjtat do të dorëzohen në arshivën e NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim:

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi